



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.05.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.
3. Projektligji “Për turizmin”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Pandeli Majko, Ulsi Manja

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ervin Mete - zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardit Çollaku - këshilltar i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Bashkim Sykja - drejtor pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Anduena Hoxha - përgjegjëse sektori pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Sonia Popa - drejtore e Përgjithshme për Turizmin

Alma Baze - drejtore e Standardizimeve për Turizmin

Enton Diamanti - përgjegjës Sektori për Turizmin

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përsëritje!

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të projektligjit “Për turizmin”. Të dyja këto projektligje kanë ardhur nga Këshilli i Ministrave, të cilat janë iniciuar dhe përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Për të paraqitur këto dy projektligji dhe për t’u dhënë përgjigje pyetjeve të kolegëve deputetë apo komenteve që mund të kenë ata ka ardhur ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, zoti Arben Ahmetaj. Bashkë me ministrin për projektligjin e parë ka ardhur zoti Ardit Çollaku, këshilltar i ministrit, dhe për projektligjin e dytë zonja Sonia Popa, drejtore e Përgjithshme për Turizmin.

Faleminderit që jeni të pranishëm!

Zoti Ministër, në fillim na bëni një paraqitje të projektligjit “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Relator për të dyja projektligjet është zoti Fino.

Zoti Ministër, fjala është për ju.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj të gjithë deputetët e pranishëm!

Ligji “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” lindi si nevojë, pas një debati të gjatë dhe të thellë, në fakt, për përshpejtimin dhe zgjerimin e gamës së investimeve vendase dhe të huaja në Shqipëri, duke iu referuar të gjitha pengesave apo vështirësive që hasin investitorët në tërësi kur tentojnë të fillojnë një investim të ri apo të vazhdojnë projektet e tyre, të cilat mund t’i kenë filluar vite më parë. Shqipëria ka parë rritje të shifrës së thithjeve të investimeve të huaja: në vitin 2013 u arrit shifra mbi 1 miliard dollarë, në 2014-n gjithashtu u arrit shifra rreth 1 miliard dollarë. Por për nevojat që ka ekonomia shqiptare nuk janë të mjaftueshme, janë larg shifrës së dëshiruar. Qeveria, pas një debati të gjatë, mendoi se nevojitet një projektligj, i cili do të afronte në parim, midis detajeve të ligjit, dy elemente kryesore: një garanci më të madhe juridike dhe një dritare unike administrative.

Një nga vështirësitë e para për investitorët është marrëdhënia me administratën. Ne mendojmë se krijimi i një njësie do të jetë eskortë administrative për investitorët. Të gjitha elementet kohore, cilësore dhe sasiore të përcaktuara në procedurë, qoftë nëpërmjet AIDA-s,

qoftë në grupet operationale që ndërton ligji në ministrit e linjës, ne mendojmë se bëjnë të mundur atë që ne i referohemi si *fast track* apo korsia e shpejtë për investitorët.

Duke iu referuar edhe prezantimeve që kam bërë te Komisioni i Veprimtarive Prodhuese dhe te Komisioni i Ekonomisë, midis pyetjeve të ngritura, që besoj se mund të ngrihen si pyetje edhe në këtë komision të nderuar, ligji nuk ofron asnjë favor për askënd, por ofron standarde dhe procedura të përsheptuara për të gjithë. Ka disa definicione në funksion të ligjit, që janë rreth 17, të cilat ndihmojnë në sqarimin e gjuhës juridike, teknike, por edhe të procedurave të mëtejshme. Investitori strategjik është caktuar në dy nivele, pra investitori i asistuar dhe investitori i veçantë. Janë përcaktuar edhe sektorët që konceptohen ose referohen si sektorë strategjikë: sektori energjetik dhe minerar; sektori i transportit, turizmi, bujqësia dhe peshkimi; sektori i zonave ekonomike dhe zonave të lira ekonomike; zonat me përparësi zhvillimi.

Në të njëjtën kohë ligji krijon pranë Këshillit të Ministrave edhe një komitet, që është Komiteti i Investimeve Strategjike, si një organ kolegjal pranë Këshillit të Ministrave, për të marrë vendime kolegjiale, por edhe unike për procedurat e agreguara, ku më pas reflektohet e gjithë procedura që ne i referohemi, *fast track*.

Ligji vendos detyrime të drejtpërdrejta për administratën që të përgjigjet me shpejtësi dhe saktësi, në bazë të ditëve të përcaktuara. Madje, përveçse u referohet dënimeve administrative, të përcaktuara në ligjin e nëpunësit civil, i jep të drejtë AIDA-s që aty ku shkelen procedurat e *fast track*-ut, që referohen në këtë ligj, të ketë mundësi të vendosë edhe gjoba.

Parimi i parë për të përcaktuar investitorin strategjik në sektorë të ndryshëm, ashtu siç e shihni edhe në draftligj, është shuma e investimit, të cilat janë të drejtpërdrejta. Brenda po atij kapitulli ka edhe referenca për atë çka do të merret parasysh për të kaluar në dhënien e statusit të investitorit strategjik.

Një nga elementet që është parë në dialog me investitorët, është ngritur në të dy këshillat, qoftë në Këshillin e Investimeve, qoftë në Këshillin Ekonomik Kombëtar, është siguria juridike, e cila, fatkeqësisht, në shumë raste është cenuar në këto 22 vjet. Ne mendojmë se investitorët strategjikë për kontratat e tyre, pasi të kenë marrë statusin dhe të kenë përfunduar procesin e tyre, qoftë garën, qoftë kontraktimin me privatët, mund të kërkojnë një garanci maksimale juridike dhe të kërkojnë që kontrata e tyre të kalojë edhe në parlament.

Ka pasur një ide, të cilën ne mendojmë se mund ta reflektojmë në të ardhmen e afërt gjatë diskutimit nën për nën, qoftë me Komisionin e Ekonomisë, qoftë me Komisionin e

Veprimtarive Prodhuese, për ta avancuar të drejtën e sigurisë juridike. Investitorët strategjikë mund të zgjedhin edhe gjykatën ndërkombëtare, me një listë të paracaktuar nga Këshilli i Ministrave, jo thjesht për arbitrazh, sepse ajo është një e drejtë e patjetërsueshme, ekskluzive, por edhe si gjykatë e shkallës së parë, t'i referon drejtpërdrejt një gjykate ndërkombëtare të paracaktuar dhe të mirënjohur.

Këto janë pak a shumë elementet parimore të draftligjit. Unë jam i bindur që nëpërmjet një ligji nuk është se dyfishohen apo trefishohen menjëherë investimet e huaja. Investimet e huaja janë të lidhura me zbatueshmërinë e ligjit, qoftë ligjit ekonomik, qoftë ligjit në tërësi, më pas vijnë elementet e tjera. Por jam i bindur se me dy elementet principale që ofron, rritjen e garancisë juridike dhe korsinë e shpejtë, *fast track*, u rrit investitorëve të huaj konfortititen në terrenin ekonomik shqiptar.

Para se ta mbyll fjalën time, dua t'ju tregoj pak historinë e bërjes së ligjit. Ligji është konsultuar me disa donatorë: me Bankën Botërore dhe me IFC-në, që është brenda grupit të Bankës Botërore, me IVSID-në, me komisionin, me SIGMA-n dhe janë marrë shembull: Kroacia dhe Greqia. Nuk kemi rënë dakord me gjithçka me donatorët, por për shumicën e parimeve po.

Unë ju falënderoj që më lejuat të bëj këtë parashtrim, por edhe për vëmendjen tuaj! Jam gati për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të falënderoj ministrin për ekspozenë e projektligjit “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”!

Nga pikëpamja kushtetuese projektligji është bazuar në nenet 78 dhe 81 të Kushtetutës. Qëllimi i përmbajtjes së këtij projektligji natyrisht është nxitja dhe tërheqja e investimeve publike dhe private vendase e të huaja në sektorët e ekonomisë, të identifikuar si sektorë strategjikë tashmë. Ky projektligj përcakton nëse investimet strategjike janë private-publike dhe publike-private në sektorin e energjisë, të minierave, të transportit, të infrastrukturës dhe mbetjes urbane, bujqësisë, peshkimit, zonës ekonomike dhe zonave me përparësi turizmin.

Projektligji përcakton ngritjen e një komiteti, siç e tha ministri, të investimeve strategjike, i cili merr vendime të shpejta dhe dhënien e statusit të një asistence për të veçuar

në mënyrë të veçantë përjashtimet strategjike që propozohen nga investitorët vendas dhe të huaj, duke ngritur rolin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit.

Në fakt, ligji është një risi shumë e mirë, sepse rrit garancinë juridike dhe korsinë e shpejtë, siç e tha ministri, për investimet e huaja ose vendase. Pra, në fund të fundit, u jep atyre një rritje të investimeve në terrenin ekonomik shqiptar. Nuk mendoj se bërja e një ligji, siç e tha ministri, do të bëjë të mundur rritjen e investimeve të huaja, por krijon një shtrat të përshtatshëm që investitorët e huaj të ndihen mirë kur vijnë në Shqipëri për të investuar, të gjejnë ngrohtësi, qoftë në sensin e agjencisë, qoftë të vendimmarrjes së komitetit, sepse investimet e huaja kanë qenë gjithmonë në nivelin e duhur. Ne pretendojmë, me kushtet që ka Shqipëria, të ketë shumë herë më tepër investime të huaja. Prandaj ky projektligji është në funksion të tyre dhe u bën të mundur investitorëve të jenë më prezent në Shqipëri.

Zoti kryetar, meqenëse mora fjalën, më lejoni të bëj dy-tri pyetje për ta kompletuar relacionin për në seancë plenare, për ta kuptuar më drejt dhe për të qenë më i qartë në bërjen e relacionit.

Së pari, cilat janë zonat me përparësi zhvillimi dhe kriteret që i përcaktojmë si të tilla? Bëhet fjalë për nenin 8 të projektligjit. A mendoni se investimet me vlerë 1 milion apo 3 milionë euro mund të konsiderohen investime strategjike, pavarësisht se punojnë njerëz? Ju në këtë projektligj keni vendosur edhe shumat e investimeve dhe numrin e punonjësve. Nga i keni marrë këto vlera që i quani investime strategjike?

Së dyti, pse në projektligj parashikohet që për disa projekte të ketë procedura konkurruese, tenderuese dhe për disa të tjera jo? Te cilat kritere jeni bazuar, e kam fjalën për pikën 4 të nenit 16 të këtij projektligji? Unë dua që të ketë gjithmonë konkurrueshmëri, jo dikush të ketë dhe dikush tjetër të mos ketë. Pra, çdo investitor që vjen këtu të jetë në kushte të barabarta.

Së treti, kur themi se kemi një ligj “Për investimet strategjike” duam të dimë se cilat janë lehtësitë fiskale për investimet strategjike? Nëse një investitor i huaj apo vendas vjen për të bërë një investim dhe quhet investim strategjik, pra vlerësohet nga komiteti dhe nga AIDA, cilat janë lehtësitë fiskale për të cilat ai vjen dhe hedh miliona, fut shumë njerëz në punë? A duhet të jenë në këtë projektligj, apo janë në projektligje të tjera, të cilat kanë të bëjnë me financat?

Nëse marr përgjigjen e këtyre tri-katër momenteve, të cilat unë do t'i quaj të ezauruara, i gjithë relacioni im do të përfundonte më mbështetjen që duhet të japim ne si Komision Ligjesh për ta miratuar projektligjin në fjalë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër, fjala është për ju për përgjigjet e pyetjeve të zotit Fino.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Fino, për relatimin dhe për mbështetjen!

Për sa i përket pyetjes se cilat janë zonat me përparësi zhvillimi, është atribut i Këshillit të Ministrave që të përcaktojë zonat me përparësi zhvillimi dhe kriteret. Po marr një shembull, le të themi që në Verilindje të vendit apo në juglindje ka zona, të cilat janë shumë të varfra, që kanë mungesë infrastrukture dhe sipërmarrjeje. Për këto arsye apo për një mijë arsye të tjera Këshilli i Ministrave me këtë logjikë mund ta konsiderojë zonë me përparësi zhvillimi dhe të bëjë atë që ia lejon ky ligj dhe ligjet e tjera, apo të krijojë, siç do ta shohim në një draftligj, që do të vijë më vonë në këtë komision, zona ekonomike, ku përsëri Këshilli i Ministrave përcakton kriteret, apo zonat me përparësi të zhvillimit të turizmit, ku Këshilli i Ministrave përcakton kriteret. Pra, është atribut i Këshillit të Ministrave që me vendime vazhduese të përcaktojë edhe zonat, edhe kriteret që qëndrojnë në themel, por dhe pas përcaktimit të këtyre zonave me përparësi zhvillimi.

Për sa u përket investimeve strategjike, u jemi referuar fushave dhe sektorëve të ndryshëm. Për shembull, po ta shihni bujqësinë, niveli është pak më i ulët se sektorët e tjerë edhe për shkak të nivelit që është sektori. Po ta shihni, ligji shkon deri në 2018-n, për t'i dhënë një shtytje momentit. Është edhe vendim politiko-teknik përcaktimi i shumave të investimit.

Nëse do të kishte një analizë dhe një debat, i cili mund të prevalonte mbi atë shifër që ne kemi vendosur, nuk është se kemi ndonjë kufizim për të përmirësuar edhe shifrat. Por shifrat janë vendosur pas një analize për sektorë të ndryshëm. Gjëra e parë, që është më e qarta, është shifra.

Punësimi, gjithashtu, është shumë i rëndësishëm dhe i theksuar, sepse në fund kjo aleancë ka në fokus punësimin. Janë dy korsi, të cilat përputhen te koncepti i gjerë i zhvillimit ekonomik.

Për sa i përket pyetjes për procedurat konkurruese, dua t'ju sqaroj se nuk ka asnjë përjashtim nga procedurat konkurruese që përcaktohen në ligje të ndryshme. Nuk ka asnjë favor që i jepet askujt. Nuk ka asnjë status që për një procedurë t'i jepet njërit dhe të mos i jepet tjetrit. Nëse për një procedurë konkurruese ka më shumë se dy apo tre investitorë strategjikë, në bazë të definicioneve të këtij ligji, kur të bëhet ligj, do ta marrin të tre ose të katërt, nuk është se do të kemi ndonjë përjashtim. Nuk do të ketë asnjë përjashtim nga asnjë garë apo tenderim.

Për sa u përket lehtësive fiskale, sektorë të ndryshëm kanë paketa lehtësish fiskale të ndryshme: energjia ka të gjitha materialet e ndërtimit; bujqësia ka përjashtime nga farërat apo nga makineritë bujqësore; manifaktura ka një paketë tjetër lehtësish fiskale dhe procedurale. Ky është ligj organik, është ligj bazë. Të gjitha lehtësitë fiskale apo procedurale që ka janë në ligjet specifike sektoriale.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Mediu, keni fjalën.

Fatmir Mediu – Faleminderit!

Pyetjen e parë unë e kam për germën “a”, pika 3 e nenit 8 për sa u përket vlerave financiare që konsiderohen si investime strategjike, po marr sektorin e turizmit, që është edhe pjesë e portofolit tuaj si ministër.

Ju thoni se do të konsiderohet investim strategjik një nivel që fillon me 5 milionë euro. A ka një krahasim me vendet e tjera në investimet strategjike të turizmit? Po të marrim shembull Malin e Zi: janë 1,3 miliardë dollarë që investohen në Lushica Bej; janë 800 milionë euro nga Sokari; janë 250 euro nga Katari. Ndërsa ne e konsiderojmë nivelin strategjik me 5 milionë euro. Ky investim nuk përmbush as kushtet e një hoteli me katër yje, që mund të jetë një biznes privat që kryhet në bregdet. A përbën ky një shqetësim, që brenda të gjitha elementeve të tjera favorizuese që u jepen këtyre në vend që të ndërtojmë një turizëm të nivelit që duam, do të ndërtojmë struktura, të cilat nuk kënaqin nevojat për përthithjen e turistëve në Shqipëri? Pra, mendoj se niveli i investimeve është një pikëpyetje, që e ngriti edhe zoti Fino.

Në pikën 2 të nenit 21 thoni se procedurat janë pesë ditë pasi agjencia e merr propozimin, pas pesë ditëve duhet ta përcjellë tek institucionet përkatëse, të cilat brenda 15 ditëve duhet të japin leje. Nëse brenda 15 ditëve nuk japin leje, çfarë ndodh? Nuk është se ministritë edhe sot nuk kanë afate, ato kanë afate. Qeveria e kaluar me procedurat e licencimit vendosi që nëse ministritë për ato licenca apo autorizime që jepeshin nga QKL-ja përgjigjja nuk jepej në kohë, atëherë fitohej statusi i të drejtës së saj i aprovimit në heshtje. Ka një shqetësim për sa u përket lejeve mjedisore dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis nga BE-ja, që nuk mund të ketë afate kaq të ngushta për vetë problematikën e madhe që paraqesin këto investime në raport me mjedisin.

Në pikën 1 të nenit 25 dhe në nenin 29 ju thoni se vihen në dispozicion toka bujqësore, pyje, pasuri të paluajtshme. Po ashtu në nenin 29 thoni që krijohet edhe fondi i pasurive të paluajtshme në dispozicion për këto investime. Ka një fond të pasurive të

paluajtshme, përgjithësisht pyje, toka kullosore apo toka bujqësore që janë detyrim, sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të çohen pranë AKKP-së. Me sa di nuk ka ndonjë sipërfaqe tjetër që nuk është përllogaritur, e cila është e lirë dhe mundshme që nuk duhet t’i adresohet asaj Agjencie, megjithëse nuk ka marrë asnjë vendim për dy vjet. A ka një konflikt ndërmjet fondit që duhet pranë AKKP-së për të plotësuar detyrimin karshi pronarëve me këtë fond, i cili tentohet të vendoset në dispozicion të investitorit strategjik, sipas konceptit që kemi parashikuar?

Edhe thoni, po ashtu, që me VKM vendoset procesi i dhënies së këtyre pasurive. Kjo bëhet sipas procedurës dhe ligjit “Për shpronësimet publike”, apo sipas një vendimi të qeverisë, që e tejkalon atë ligj?

Te neni 26, thoni që, nëse nuk bihet dakord ndërmjet pronarit dhe investitorit, atëherë veprimet kryhen nga shteti, sipas procedurës që vendos Këshilli i Ministrave. A ka një konflikt këtu me të drejtën e pronësisë dhe të drejtën e zhvillimit të pronës?

Neni 27, po ashtu, thoni: “Vendimi i qeverisë për përdorimin e vijës bregdetare apo zonave të liqeneve” e me radhë. Ky është një problem që ndoshta kërkon zgjidhje që te ligji “Për turizmin”, që do të vijë më prapa. Ç’kuptim ka që të pretendosh që të investosh qindra milionë euro e të mos kesh akses për të përdorur atë pjesë të bregdetit?

Thatë që keni rritje të thithjes së investimeve në Shqipëri. Zoti Ministër, transferimi i kapitaleve jashtë Shqipërisë është rritur në vlerën 140% për vitin e kaluar. Kjo tregon një tendencë për t’u larguar nga investimet në Shqipëri, duke kapur një vlerë rreth 70-80 milionë euro, të paktën, sipas INSTAT-it: a është ky një shqetësim, në një kohë që tentojmë të ndërtojmë ligje për thithjen e investimeve strategjike? Ku janë problemet?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Mediu!

Zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po i referohem pyetjes së parë, në lidhje me nenin 8, që ka të bëjë me definimin kuantativ, sasior, të investitorit strategjik.

Për sa i përket pjesës 5 milionë, e para duhet të bëjmë dallim se kjo shifër është për investitorët e asistuar, jo për ata të veçantë. Në këto 20 vite, investimet në turizëm janë akoma modeste. Shifra 5 milionë euro është rëndësishme. Nuk jep asnjë favor, në fakt, si i asistuar përveçse *fast-track*-un. Pra, jo favor individual, por standard, për këdo që investon 5 milionë për atë që quhet “dritare unike” dhe “korsia e shpejtë”.

Ajo që ju referuat, “aprovimi në heshtje”, patjetër që është në formatin ligjor. Po ta shikoni me kujdes procedurën, atje ka ditë të definuara për përgjigje. Gjithashtu, detyron investitorin, por mbi të gjitha administratën, që të komunikojë brenda një kohe të shkurtër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndodhin dy gjëra. Po marr një shembull tipik. Nëse një investitor duhet të marrë një leje, le të themi në rastin kur nuk i ka dokumentet në rregull, administrata është e detyruar që brenda dhjetë ditëve t’i kthejë përgjigje. Ky komunikim bëhet vetëm një herë, jo pa fund, sepse e vërteta është që administrata zvarrit, duke kërkuar letra pa fund. Ajo që duam të fshijmë - jam i bindur se do ta përmirësojmë procedurën - është burokracia. Në momentin që administrata nuk kthen përgjigje, hyn “aprovimi në heshtje”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka nevojë të parashikohet këtui, sepse është në një ligj tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të gjitha kalojnë te QKL-ja, qoftë lejet e turizmit, qoftë ato energjetike, të ambientit, të cilin e njihni mirë, sepse e keni drejtuar atë sektor, pra, nuk përjashtohet asnjë favor standard që është dhënë në ligje në kohë. Vetëm shton detyrimin për administratën që të jetë korrekte e të definuar në kohë.

Fondi i pasurive të paluajtshme. Së pari, duhet ta definojmë atë, në aspektin fizik. Për këtë gjë, po bëhet një përpjekje brenda Ministrisë së Ekonomisë për të gjitha asetet publike, të cilat nuk i përkasin vetëm kësaj ministrie, të Mbrojtjes apo të Rendit, por gjithçka që është në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe njësitë vendore. Logjika e fondit që kompenson është e një logjike tjetër ligjore. Ju e dini po aq mirë sa unë, se që të shkojë një aset publik te fondi i kompensimit, ka një rrugë ligjore dhe procedurale të paracaktuar, që nuk preket nga ky ligj. Do të duhet vetëm të ketë një kërkesë të drejtpërdrejtë nga investitorët për atë terren apo atë aset publik, me një program investimi konkret. Pra, të ketë një kërkesë për t’u tërhequr dhe hequr nga fondi i kompensimit, në bazë të VKM-së 54. Do t’i referohemi ligjit bazë “Për shpronësimin për interes publik”, nuk do të ketë një procedurë të re. Nuk po e shtroj për debat të mëtejshëm, sepse është përcaktuar shumë qartë.

A hyn shteti, kur ka një investim 5 milionë për turizëm? Nuk hyn. Hyn vetëm tek investimet me procedurë të veçantë. Me 5 milionë, në turizëm është vetëm i asistuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, në bujqësi shteti do të ndërhyjë.

Ju folët për daljen e kapitalit. Është debat i gjatë. Do t’ju sjell ca shifra. E para, dy vjetët e fundit kanë njohur shifra rekord të investimeve të huaja. Këtu nuk përfshihen

privatizimet. 1,2 miliardë dollarë nuk i mjaftojnë kësaj ekonomie. Duhet të kalojë 1,5-2 miliardë dollarë në vitet që vijnë, në mënyrë që të fillojmë të shohim edhe rritje shumë më të madhe ekonomike, duke kaluar shifrën 2,4%.

2% është e rëndësishme si rritje ekonomike, por akoma nuk përkthehet aq sa duhet në rritje të mirëqenies, po nuk kaloi në 4%, 4,5% apo, në rastin e ekonomisë shqiptare, në 5%. Ka dy faqe të largimit të kapitaleve. Nuk është shifër alarmante, sepse hyrja neto është pozitive: e konfirmon Banka e Shqipërisë.

Një nga elementet që duam të sjellim me këtë ligj, është garancia juridike, e cila, në 22 vite, ka qenë e cenuar në shumë raste. Mund t'ju sjell dy shifra interesante.

E para, janë importuar gati 1 miliard dollarë makineri dhe pajisje, për vitin 2014. Është një shifër domethënëse, përtej çdo debati politik, sepse shqiptarët po importojnë makineri dhe pajisje.

E dyta, për herë të parë ekonomia shqiptare eksporton makineri: 15 milionë dollarë në vit. Dyfishi i të gjitha kohërave.

Po them se ka filluar të rigjallërohet struktura prodhuese. Mos harroni se kemi eksportuar 43% më shumë materiale ndërtimi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ristani. Pastaj zonja Hysi.

Arben Ristani – Te neni 3, pika 17, kur sqaroni memorandumun e mirëkuptimit, shpreheni “marrëveshja përgjithësisht jo detyruese”, çka kupton se mund të jetë edhe detyruese. Për të ardhur te neni 14, te memorandumun i mirëkuptimit, ky memorandum mund të bëhet edhe në fazën që shprehet interesi. Në përmbajtje të memorandumit, palët, qeveria për shembull, do të shprehin zotimet dhe premtimet e veta, karshi subjektit. Vijnë te neni 16, pika 4, ku do të bëhen procedurat tenderuese, konkurruese. Edhe ky ka një problem. Fillon “në rastin e zhvillimit të procedurave konkurruese”, që do të thotë se ka edhe raste ku mund të mos ketë të tilla. Po t'i lidhim të katra, do të thotë që mund të ketë procedura preferenciale jokonkurruese, ku sa shprehet interesi, bëhet memorandumun i mirëkuptimit, kështu që nuk ka nevojë për procedura konkurruese?

A e kam kuptuar drejt?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ristani!

Zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Ristani!

Pak historik për memorandumimin e mirëkuptimit: të gjitha qeveritë bëjnë memorandumime mirëkuptimi jodetyruese me investitorët. Është hapi i parë i një marrëdhënieje potenciale, por nuk detyron as qeverinë, as investitorin. Detyrimet janë për informacion publik. Deri më sot ka qenë një vullnet nga ana e qeverisë: pra, në ministrinë e ndryshme bëhen këto memorandumime, por diku mund të mos bëhen. Ishte në diskrecion të ministrit ose të administratës. Tani ia japim këtë të drejtë dhe detyrim institucioneve. Nuk ka asnjë përjashtim nga gara. Aty ku nuk ka garë, por investitorët, që janë të mëdhenj, kërkojnë njohje të projektit të tyre nga qeveria, një garanci morale e hapit të parë.

Pyetjet janë të ligjshme, por ju garantoj se këtu nuk ka asnjë përjashtim apo favor individual nga asnjë procedurë gare apo tenderi.

Arben Ristani – Ju konfirmoni që marrëveshja e memorandumit nuk do të jetë detyruese. Ndoshta biem dakord se kur thuhet “marrëveshje përgjithësisht jodetyruese”, për mua do të thotë se mund të jetë edhe detyruese. Po t’i qëndrojmë fjalës suaj se do të ketë procedurë konkurruese, duhet të ketë një korrigjim këtu.

Ajo që e ka memorandumimin e mirëkuptimit, a mund të jetë më e favorizuar se ajo që nuk e ka? Përndryshe, duhet të jetë standard: çdo shoqëri që futet në procedurë, duhet të ketë memorandumimin e mirëkuptimit.

Arben Ahmetaj – E drejtë është kjo që thotë zoti Ristani, por, duke u nisur nga logjika që kemi vendosur te pika 17 e nenit 3, është që investitori potencial mund ta kërkojë memorandumimin e mirëkuptimit. Nuk e japim këtë marrëveshje, nëse nuk kërkohet. Kush e kërkon, e merr. Marrëveshja e mirëkuptimit nuk ka asnjë vlerë në procesin e tenderimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj e kemi vendosur këtu.

Deri tani mund ta jepnim dhe mund të mos e jepnim, sepse nuk kishin asnjë detyrim. Tani, po na e kërkuan, jemi të detyruar ta japim, në mënyrë që të ketë garancinë morale dhe njohjen e qeverisë me projektin e tyre, qoftë privat, qoftë publik-privat, qoftë shtetëror.

Konkretisht: nuk ka vlerë si marrëveshje në procesin e tenderimit dhe nuk i refuzohet askujt që e kërkon, në bazë të logjikës së këtij ligji.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Ministër!

Unë e vlerësoj sjelljen e këtij projektligji, sidomos në rregullimin investimeve strategjike dhe krijimin e regjistrimit të investimeve strategjike, por kam disa pyetje për raportin

midis atij investitori që përfiton nga procedura e asistuar dhe shërbimeve lehtësuese që i ofrohen.

E kam fjalën për nenin 19, në raport me nenin 24, 25, 26 dhe vlerën e investimit, shqetësim që e ngritën pothuajse të gjithë kolegët. Në nenin 8 ju thoni që mund të jetë një investim strategjik në sektorin e zonave me përparësi zhvillimi, i barabartë ose më i madh, me 1 milion euro. Ndërkohë, të neni 19 i jepet mundësi këtij investitori të përfitojë konsolidimin e tokës, programe mbështetëse etj. A ka një raport midis vlerës së investimit, që mund të jetë 1 milion, me vlerën e programeve mbështetëse, ku përfshihet ndërtimi i rrugëve, shpronësimi, shpyllëzimi, dhënia e ndërtesave etj?

Nëse vlera e shërbimeve mbështetëse del e barabartë me 1 milion euro, a është shërbim apo investim strategjik?

Pyetja e dytë ka të bëjë me garancinë juridike. Është e vërtetë, kemi probleme me të. Çfarë ndodh, nëse konstatojmë gjatë zbatimit të projektit investues se investitori ka dhënë të dhëna të pavërteta? Neni 18 thotë se e revokon vendimin, po çfarë ndodh me ata që janë shpronësuar, me rrugët dhe investimet që ka bërë shteti? Procesi i revokimit del i paqartë.

Kemi kaluar Kodin e Procedurave Administrative dhe i kemi dhënë rëndësi “miratimit në heshtje”. A ka administrata jonë kapacitete që brenda këtyre periudhave që keni përcaktuar me ligj, maksimumi 30 ditë, të vlerësojë të gjithë dokumentacionin e një investimi strategjik, me mijëra faqe dokumente, si edhe verifikim të të gjitha proceseve dhe shërbimeve mbështetëse lehtësuese që duhen krijuar?

Gjithashtu, më shqetëson neni 20, pika 2. Disa herë ky komision, sidomos zoti Fino, ka reaguar fort, lidhur me sjelljen në Kuvend të kontratave për grante të ndryshme. Në nenin 20 ju thoni që si garanci për investitorin është miratimi nga ana e Kuvendit, kur vlerësohet nga Këshilli i Ministrave, i kontratave përkatëse të investimit strategjik, me kërkesë të investitorit, por nuk e keni lidhur fare me vlerën kontratës.

Këtu në komision jemi dëshmitarë se na vijnë grante shumë të vogla, që nuk ka pse të investohet Kuvendi. Nuk e di pse kërkohet kjo. Për ta kaluar përgjegjësinë te Kuvendi i Shqipërisë?

E fundit: më shqetëson pak raporti midis investimit ose programeve mbështetëse që do t'i jepet një investitori, qoftë edhe për 1 milion euro, dhe mbrojtjes së mjedisit. Kur kemi kaluar ligj, një nismë të Ministrisë së Mjedisit, kemi reaguar në komision, që në kuadër të koncesioneve mjedisi është shkatërruar, pasi investitorët nuk mbajnë përgjegjësi për pyllëzimin, rregullimin e gjithçka tjetër. Edhe këtu nuk shoh ndonjë dispozitë. Nëse ka dhe unë nuk jam e vëmendshme, ju kërkoj ndjesë, por unë nuk shoh ndonjë dispozitë që ta

detyrojë një investitor që ta ketë dëmin sa më vogël. A do të ketë ndonjë detyrim, ku revokohet...?

Në nenin 18, kur investitori ka sjellë një fakt jo të vërtetë, ti revokon, por nuk parashikon asnjë pasojë. Pasojat më të mëdha janë ato mjedisore. A do të përgjigjet ai? Mjedisoret janë të pa riparueshme. Nëse ka shkatërruar pyllëzimin, shtretërit e lumenjve e shumë gjëra të tjera...

Këto janë pyetjet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ta nis nga e fundit, që është pak ligjore dhe emocionale për momentin, për momentin, për ndjeshmërinë që kemi ne si maxhorancë për ambientin. Është e drejtë ajo që thoni ju, që ambienti vjen i pari dhe ky ligj nuk merret fare, por revokon statusin si investitor strategjik i asistuar ose me procedurë të veçantë. Për dëmin që mund t'i ketë shkaktuar ambientit, është ligji specifik që i referohet drejtpërsëdrejti kur ka detyrime. Për shembull, kur për shkak të një projekti apo për shkak të investimit për të pastruar ambientin, shpyllëzon, këto janë të definuara dhe shumë të qarta në ligjin e ambientit. Pra, ky është ligj që nuk revokon lejen e ambientit, por statusin, dhe në momentin që revokohet i humbet të gjitha favoret standarde që ofron ky ligj. Në qoftë se investitori ka shkelur ligjin “Për ambientin”, ai u nënshtrohet të gjitha masave administrative, penale ose financiare të këtij ligji. Kjo është e para.

E dyta, ju iu referuat nenit 20 dhe thatë se nuk e keni të lidhur me shumën. T’ju sqaroj, zonja Hysi, që neni 20 bën pikërisht atë gjë, e lidh detyrimin me shumën. Po ta shikoni, thuhet: “shërbime ndaj investitorit në rastin e procedurës së veçantë”. Procedura e veçantë është e lidhur drejtpërsëdrejti me shumën. Po flasim për kapacitetet administrative, dhe është një debat i gjatë. Unë mendoj që administrata shqiptare...

Fatmir Xhafaj – Nejse, shuma nuk është kriter që të vijë projekti në Kuvend. Nuk ka rëndësi kjo.

Arben Ahmetaj – Kryetar, unë po i përgjigjem zonjës Hysi. Më pas është gjykim politiko-teknik apo edhe juridik.

Fatmir Xhafaj – Është kushtetues, zotëri.

Vazhdo përgjigju!

Arben Ahmetaj – Kryetar, më bëri pyetjen nëse është e lidhur me shumën. Pastaj, nëse logjika e lidhjes me shumën është e drejtë apo mund të përmirësohet, është një diskutim tjetër që mund ta hapim, nuk është problem. Është vendimmarrje politiko-teknike që vazhdohet edhe në këtë komision.

Tjetra është, a ka kapacitete administrata? Në këndvështrimin tim personal, si ministër, jo thjesht si individ, administrata shqiptare është ende larg të qenurit administratë për t'iu përgjigjur investimeve të huaja apo investimeve në tërësi. Ka 22 vjet që nuk arrin dot t'u përgjigjet. Dëshironi të them se administrata është spektakolare? Jo, ka 22 vjet që nuk është në atë lartësi që të marrë një projekt dhe të mos flejë mbi atë, madje ka projekte që administrata i ka prej 10 vjetësh.

Ky ligj vendos data dhe penaltete për administratën dhe u jep të drejtën investitorëve që të jenë më legjitim dhe “arrogantë” kur administrata fle mbi një projekt. Kur them “arrogant” e fus në thonjëza, për të thënë që ka të drejtë ta kërkojë me këmbëngulje atë që pret nga administrata. Kjo është sfida. Ky ligj nuk zgjidh atë sfidë që ju bëtë pyetje. Pyetja se nëse ka administrata kapacitete është drejtë, por gjithë projektet dhe programet që bëhen për rritjen e kapaciteteve shkojnë në atë drejtim. I bie që të bëjmë edhe një pyetje që është shumë e vështirë: a është administrata gati për t'u afruar në Bashkimin Europian? Është shumë legjitime ajo që thoni ju, por me këtë ligj ne tentojmë të detyrojmë, madje edhe të penalizojmë.

Ju solla një shembull për zona shumë të varfra ku janë 1 milion euro për zonat me përparësi zhvillimi. Unë besoj se 1 milion euro për zonat me përparësi zhvillimi nuk janë pak, sepse kjo është e lidhur edhe me punësimin, që ne si maxhorancë e kemi pjesën kryesore të të gjithë asaj përpjekjeje të përditshme që bëjmë. Besoj se 1 milion nuk janë pak, por nuk është procedurë e veçantë, është e asistuar. Konsolidimi i tokës bëhet si për të asistuarën, si për të veçantën, por konsolidimi i tokës është asistimi që i bën qeveria, po e them në një format më të përgjithshëm, për të bashkuar tre, katër ose edhe dhjetë pronarë privatë. Po flasim për të asistuarën, sepse e veçanta ka edhe favore pak më standarde për të bërë të mundur investimin prej 1 milion eurosh. 1 milion euro janë të domosdoshme për ekonominë shqiptare. Si Këshill i Ministrave ne kemi gjykuar se 1 milion në këto zona...

Në qoftë se ka një këndvështrim dhe një analizë tjetër, unë ngelem i hapur.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka tjetër? Keni prapë pyetje? Jo, e mbyllim me pyetjet.

Atëherë, zoti Mediu, më pas zoti Vasili.

Fatmir Mediu – Pa dyshim që në situatën e vështirë ekonomike që kalon vendi, e përcaktuar si e tillë edhe nga raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar, është shumë e rëndësishme që ne të kemi mundësi për të ofruar investime strategjike dhe të qenësishme që i japin shtytë zhvillimit ekonomik dhe punësimit në vend.

Disa nga problemet që u ngritën këtu, duhet të jenë preokupim i një analize më të thellë brenda këtij draft projektligji. Do të ishte mirë, zoti kryetar, që, kur na vijnë ligjet nga ministritë përkatëse, të vijnë të bashkëshoqëruara edhe me mendimet e ministrive të tjera. Flas për Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Energjetikës, ministri të cilat lidhen, në mënyrë që të kemi edhe një reflektim më të plotë rreth projektligjit, sepse specialistët përkatës janë ministritë përkatëse dhe brenda kësaj ne krijojmë një gjykim më të qartë, qoftë për vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave apo për vlerën e projektligjeve që përcillen në Komisionin e Ligjeve. Mendoj se do të ishte e rëndësishme, sepse kështu mund të flasim më tepër mbi bazën e gjykimit të specialistëve dhe japim një gjykim më të drejtë për vendimmarrjen e përbashkët parlamentare dhe politike në miratimin e ligjeve.

Gjithmonë shqetësimi është sepse sipas këtij ligji ne kemi përcaktuar sektorë dhe investitorë strategjik, ku kemi futur të gjitha fushat e zhvillimit ekonomik të vendit, nuk i kemi përjashtuar. Ajo që ka ndodhur dhe që është një fenomen preokupant për sa u përket investimeve në Shqipëri, është që shpesh nën petkun e investitorëve strategjikë vijnë brooker, të cilët përfitojnë të drejtat dhe kontrata që ju ofron ligji në Shqipëri, të cilat asnjëherë nuk implementohen, madje kthehen në kosto negative për ekonominë, për qytetarët shqiptarë, por edhe me pasoja të drejtpërdrejta financiare për shtetin shqiptar.

Jo rrallë ka rastisur që kontratat, të cilat nuk kanë qenë asnjëherë të legjitimuara si investime konkrete, nuk kanë pasur një bazë financimi konkret, kanë shkuar në interes të atyre që kanë ardhur si brooker në arbitrazhe apo në gjykata të huaja për shkak të elementeve të kontratës që ka firmosur qeveria shqiptare.

Mendoj se ky është një moment shumë i rëndësishëm. Edhe shqetësimi i koleges Hysi është tërësisht i drejtë, që garancia juridike e shtetit shqiptar është njëra anë, e cila ka çaluar në mënyrë absolute gjatë këtyre viteve të fundit për shkak të prishjes së njëanshme të kontratave dhe veprimeve të njëanshme të administratës, por është edhe ana tjetër e garancisë juridike të investitorëve strategjikë për të kryer investimin që ata kanë propozuar, sepse jepen një sërë favoresh në raport me investimet e tjera.

Në rast se këta investitorë nuk do të japin të gjitha garancitë juridike dhe financiare, pavarësisht se janë shkruar në ligjin e mjedisit apo në ligje të tjera, është e pamundur që shteti të përfitojë pjesën e financës apo rehabilitimin e mundshëm që duhet për shkak të veprimtimit jo

të drejtë të firmës investitore që konsiderohet strategjike në këtë rast. Prandaj duhen parë të gjitha aspektet dhe shtrëngesat juridike, jo vetëm me gjoba siç janë parashikuar këtu apo siç parashikojnë ligjet e tjera për ata që konsiderohen investitorë strategjikë, por edhe kriteret pse duhet të jenë të tillë dhe shtrëngesat për të realizuar investimin për shkak të vetë mundësive që jep shteti, jo vetëm për procesin trace & strack, por edhe me elemente të tjera të licencimit, të bashkinvestimit, të investimit të punëve publike në krijimin e mundësive për ta kryer këtë investim, në shpronësime publike që bëhen për interes të tyre dhe në bashkëpunim të vetë qeverisë duke u bërë aksioner sipas këtyre parashikimeve.

Ajo që më shqetëson dhe që po e ngre sërish si çështje, është që përputhshmëria ndërmjet afateve që ju keni vënë dhe disa ligjeve të mjedisit, besoj se nuk është e plotë për vetë faktin se debati është bërë me kohë, jo vetëm sot. Për shembull, vlerësimi strategjik mjedisor kërkon një kohë relativisht të madhe, vlerësimi i mjedisit kërkon po ashtu kohën e vetë të domosdoshme, e cila e kalon afatin 15-ditor që ju thatë, për të kthyer një përgjigje. Prandaj them që ndoshta duhet parë në këtë këndvështrim një rakordim me gjithë legjislacionin, edhe me prokurimet publike, që të mos kemi përjashtime abuzive, edhe me ligjin “Për mjedisin”, edhe me ligje të tjera, në mënyrë që afatet që vendosen, të respektohen.

Në qoftë se nuk respektohen, duhet të ketë detyrime dhe penaltete në nivel ministrash, sepse janë ministrat ata që, në fund të fundit, kanë autoritetin për të drejtuar, dhe nuk ngelet thjesht tek administrata. Shumë dosje që flenë janë edhe për shkak të neglizhencës së autoriteteve politike që drejtojnë ministrinë, sesa janë thjesht të autoriteteve të administratës publike që janë pjesë e asaj ministrie.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrît Vasili – Unë do të thosha vetëm disa fjalë, duke qëndruar në thelbin parimor të ligjit.

Ndoshta është nga rastet e rralla, ku sigurisht kam provuar një pozitivitet konkret lidhur me një nismë ligjore, sepse thelbi i asaj që ne kemi në duar është një qasje mendjehapur ndaj investimeve përkundrejt qëndrimit tradicionalist shumë protektiv me elemente burokratike të një bezdie pa fund, të cilat kanë qenë shkak themelor për kthimin dhe për zënien e një numri pafund investimesh ndër vite.

Sot përfundimisht i japim një përgjigje të re asaj që quhet atraktivitet i Shqipërisë dhe që e mundëson atë të dallojë nga të tjerët në rajon. Sigurisht, është nga ato përgjigje, që, kur biznesi i merr në dorë, fillon ndihet më optimist dhe tërhiqet për të bërë atë që quhet aventura e tij e radhës apo garën e investimit të radhës.

Si çdo ligj tjetër, është normale të ketë korrektime të karakterit teknik, të cilat për mua janë krejtësisht minimale dhe të parëndësishme në raport me atë që është thelbi i tij, dhe në mënyrë të veçantë, përveç sektorëve, të cilët janë tradicionalisht të njohur, që ku ka pasur shprehje të interesit të caktuar, ka pasur njëkohësisht edhe politika të caktuara, siç ka qenë energjetika, është absolutisht shumë pozitive, që bujqësia dhe turizmi konsiderohen sektorë strategjikë dhe si të tillë janë dy sektorë të cilët potencialisht kanë qenë sektorët më pak të eksploruar, me resurse shumë të mëdha zhvillimi, që lidhen drejtpërsëdrejti me profilin natyror dhe social të vendit dhe konsiderimi si i tillë, është një përgjigje besoj, nga më të rëndësishmet që ne kemi dhënë në këto 1 vit e gjysmë të maxhorancës së re.

Një gjë tjetër të rëndësishme që do të doja të shtoja lidhur me shifrat e investimeve. Pajtohem plotësisht me mentalitetin, pse jo edhe pragmatist, të propozuesve të ligjit dhe të qeverisë për investimet që janë konsideruar 1 milion euro.

Realiteti social dhe zhvillimor që ne kemi në Shqipëri, të cilin, të gjithë kolegët që janë në sallë, edhe për hir të detyrimeve politike, e kanë prekur me dorë, është kaq i përthyer dhe ka zona, në kuptimin metaforik të fjalës, të thata, të cilat vuajnë për çdo lloj investimi, ku jo 1 milion euro, por edhe investimi në rendin e 100 mijë eurosh kanë impaktin e tyre.

Në rast se duam vërtet që të ketë një lloj kapilariteti në investime, ku zona të caktuara, për resurset që kanë, mund të kenë investime spektakolare, por, ne detyrimisht jemi këtu për të menduar që kudo të ketë shprehje interesi dhe lëvizje të biznesit, sepse jetohet dhe ka komunitete, të cilët, për arsye të mungesës së investimeve, ndihen shpresëhumbur në ato zona ku jetojnë dhe braktisja e këtyre zonave është një fenomen tragjik, por edhe grumbullimi i tyre pa kriter në qendrat e mëdha, e bën edhe më të vështirë jetën në këto qendra urbane.

Mendoj që mënyra sesi ligji i qaset problemit dhe mbi të gjitha, mendjehapja për të pasur një ambient më atraktiv në një botë, e cila është bota e garës, që ambientet më atraktive janë ato që fitojnë dhe ato që janë më burokratike, më konservatore janë ato që fitojnë më pak, besoj na vënë në një pozicion më të avantazhuar, ku miratimi sa më i shpejtë do të ishte gjëja më e mirë, edhe sikur ta kishim ndonjë vit më parë këtë ligj në dorë, do të kishte qenë edhe më mirë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino – Për ta përmbledhur, zoti kryetar, megjithëse është fundi, unë edhe një herë e falënderoj ministrin për përgjigjet që dhanë, përjashtoj projektligjin dhe debatet që

bëmë sot, sepse na dha mundësinë që të kuptojmë më në thellësi, le të themi, çështjet që kanë të bëjnë me investimet strategjike në Shqipëri!

Mendoj që zgjerimi i gamës së investimeve, siç u tha nga ministri, rreth 1 miliard në vitin 2013 apo në vitin 2014, e thashë edhe në fjalën time, nuk është se do ta rrisë ky projektligj që ne bëme, por për të gjitha mundësitë që ne i krijojmë biznesit të huaj dhe vendas, do të bëjë të mundur që ne të jemi shumë të hapur dhe të kërkojmë një rritje të mëtejshme të investimeve të huaja, që do të thotë rritje e garancisë juridike, korsi e shpejtë apo rritje të investimeve në një territor shqiptar të hapur dhe me shifra të ndryshme, ashtu siç tha zoti Vasili, që ka zona që edhe me 1 apo me 3 milionë euro, dhe janë vërtet zona që ia vlejnë të quhen zona me investime strategjike. Mendoj se ky është një projektligj që duhet ta ndihmojë ekonominë shqiptare.

Nga ana tjetër, po them edhe dy gjëra konkrete. Disa nga ne që kanë një njohje për shkak të eksperiencës, që kanë qenë ministra apo drejtues, mundohen ta lidhin çdo projektligj me ministrinë që kanë drejtuar, që do të thotë se në qoftë se zoti Mediu na thotë se do të ishte mirë të vinin mendimet e ministrave të tjera për të parë dhe për të rakorduar këtë projektligj me mendimet e ministrave të tjera, ky është një projektligj që vjen në emër të Këshillit të Ministrave, që do të thotë se këtë koordinim dhe këtë rakordim të Këshillit të Ministrave nëpërmjet sekretarit të Përgjithshëm, e ka bërë para se të vinte në parlament. Domethënë, ka bërë një rishikim të plotë të të gjithë situatës së ministrave, e ka kaluar në qeveri dhe nga qeveria e ka kaluar këtu.

Ajo që mua më pëlqeu më tepër është se ministri ishte i hapur për të diskutuar nën për nen, qoftë për nenin 8 apo për nenet e tjera, për të cilat unë kam vërejtje dhe sugjerime të caktuara, ku ne mund të bëjmë ndryshime të nevojshme dhe që nuk e prekin thelbin dhe cilësinë e këtij projektligji.

Pyetjet që bëra ishin në funksion të relatimit për të cilin unë fola dhe mendoj se është shumë e përshtatshme që ne ta miratojmë sa më shpejtë projektligjin, natyrisht me ndryshimet që mund të bëjmë duke e diskutuar këtë projektligj nën për nen.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Mos u sqaro kot për atë, sepse nuk ke të drejtë.

Dakord. Nuk diskutohet fare.

Fatmir Mediu – Unë mendoj si deputet...

(Diskutime pa mikrofon).

Bashkim Fino - Nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë, edhe në qeverinë e Saliut, edhe në këtë qeveri, kalojnë në të gjitha ministratë. Nuk mund të vijë këtu vendimi i Ministrisë së Mjedisit. Kaq thashë.

Fatmir Mediu – Po, ruaje mençurinë tënde për vete.

E para, pse e ngre zërin? Mos e ngri zërin!

Ne jemi deputetë, nuk jemi përfaqësues të qeverisë, dhe si deputetë kemi edhe një funksion kushtetues të kontrollit dhe vendimeve të qeverisë.

Pa dyshim që është e drejta e sekretarit të Përgjithshëm të bëjë koordinimin, por është edhe e drejta e Këshillit të Ministrave që të vendosë në kundërshtim me mendimin e specialistëve apo gjykimin e një ministrie përkatëse edhe kur nuk është koordinuar.

Ne si deputetë, në një proces vendimmarrje për një ligj kaq të rëndësishëm, mendoj se do të ishte mirë të informoheshim për të pasur një gjykim më të drejtë në raport me projektligjin që përcillet. Nuk them që ky projektligj ka pasur kundërshtim ose jo, por ajo që kërkoja është se për sa kohë ka shqetësime që ngrihen nga deputetët, pavarësisht nga kahet politike, do të ishte mirë të njihnim edhe ne mendimin e specialistëve.

Kuvendi i Shqipërisë nuk ka specialist mjedisi, ose të paktën në këtë komision nuk u është ofruar mundësia deputetëve për një konsultim të gjerë siç e ka ekzekutivi dhe ministrat përkatës. Në këtë pikëpamje do të ishte mirë të njiheshim me mendimet e këtyre ministrave të linjës, dhe nuk ka asgjë të keqe, sepse kjo rrit transparencën dhe jep mundësinë e një gjykimi më të drejtë dhe më të thellë deputetëve në vendimmarrje, që të mos ngelen vetëm në kuadër politik, të thonë po ose jo.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Duhet sqaruar që unë ua dhashë fjalën, sepse duhet sqaruar gjërat, por qasja juaj është tërësisht e gabuar. Një projektligj kur vjen këtu, vjen në emër të Këshillit të Ministrave, sa kohë që është propozim i Këshillit të Ministrave, është vullnet i qeverisë, nuk është vullnet i një ministri të caktuar. Nëse ne kemi interes që të dimë se çfarë mendon ose çfarë problemesh ka, për këtë gjë mund të kërkonim seancë këtu, të vijmë ministrat, apo të vijmë ekspertët, të kërkonim ekspertë. Këtu fillon dhe mbaron e gjithë historia, por ne nuk mund t'i kërkojmë korrespondencën e brendshme qeverisë për projektligjin që ka sjellë. Kjo nuk është në të drejtën tonë dhe nuk është në detyrimin e tyre që ta plotësojnë.

(Zoti Xhafaj i drejtohet zotit Mediu.) Kur folët, zoti Mediu, unë ju dëgjova, pavarësisht se që në fillim kur folët unë isha absolutisht kundër dhe vazhdoj të jem. Mund ta shikoni në detaj. Nëse juve ju duhet një ekspert për këtë projektligj, apo për një projektligj tjetër, mund ta kërkonim këtu në mbledhje dhe ne e marrim përsipër të sigurojmë ekspertizën e

nevojshme. Absolutisht është kështu. E keni bërë me dhjetëra herë në këtë komision dhe jam i gatshëm ta bëj këtë gjë.

(Zoti Mediu flet pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Komisioni i Ligjeve është i përbërë nga deputetë që kur t'u jepet fjala duhet të flasin. Tani e kam unë fjalën, nuk e keni ju.

Për ta përmbyllur të gjithë diskutimin që po bëjmë, unë jam dakord me kolegët që projektligji është një projektligj i rëndësishëm, vullnetmirë, që kërkon të forcojë rolin e investimeve në ekonominë e vendit dhe natyrisht besoj me çfarë u kuptua do të ketë mbështetjen e të gjitha krahëve, sepse në fund të fundit kjo nuk as për një maxhorancë, as për një opozitë, për një apo tjetrën forcë politike, por është në interes të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Nëse ka diçka që duhet ta bëjmë më mirë këtu janë të gjithë të mirëpritur dhe mund të diskutojmë për ta bërë më mirë.

Por ajo që është shumë e rëndësishme, qëllimi, është tejet pozitiv për qytetarin, për ekonominë e vendit dhe si i tillë duhet mbështetur. Po të më pyesni mua personalisht unë do të dëshiroja një gjë tjetër, por është Këshilli i Ministrave që ka gjetur këtë zgjidhje. Do të preferoja një ligj kuadër për investimet strategjike, një ligj i cili t'u jepte më shumë lehtësi në përdorimin e legjislacionit vendas investitorëve që do të thotë se ky ishte një ligj më i plotë që të mos detyrohej të kapërcente sa në njërin ligj në tjetrin ligj, një investitor që vendoste të vinte për të investuar. Por karakteri i ligjit, e thotë që në nenin 1, iniciuesi, Këshilli i Ministrave, që ky është një ligj për procedurat dhe rregullat që zbatojnë. Pra, është më shumë një ligj që ka të bëjë me aspektin procedural të trajtimit të investimeve.

Gjithsesi iniciatorët, propozuesit, qeveria në rastin konkret ka parashikuar gjithashtu edhe disa masa mbështetëse për të cilat do t'i kërkoja këshilltarëve që të jenë të kujdesshëm, sidomos nenet 25, 26 kanë nevojë për t'u parë me legjislacionin kuadër, sepse ne jemi të interesuar dhe është pozitive ajo çfarë është parashikuar në ligj për t'i dhënë mbështetje sidomos në rastin e pasurive të paluajtshme të personave privatë për të zgjidhur konflikte të mundshme, eventuale që janë jo pak te ne dhe për shkak të natyrës së regjimit juridik mbi tokën, por gjithsesi duhet të jemi shumë të kujdesshëm në formulimet që bëjmë në mënyrë që ligjet kuadër të mos përplasen me këtë ligj të rëndësishëm, por nen për nen besoj unë. Duhet të jemi të vëmendshëm për ta parë me kujdes si interesin e qytetarit, ashtu dhe interesin e shoqërisë në tërësi që të jenë të harmonizuara për të mos krijuar pastaj konflikte sociale që do të ishin jo shumë pozitive dhe që mund të prodhonin dhe tension social në një moment të caktuar siç ka ndodhur.

Por, nga ana tjetër, kjo situatë që kemi ne këtu sot në vend është frenuese si e tillë. Është shumë frenuese për zhvillimin e bizneseve të vlerave të konsiderueshme, që kërkojnë sipërfaqe të konsiderueshme dhe që kërkojnë garanci të forta dhe siguri juridike të qëndrueshme. Është shumë e rëndësishme. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm për t'i harmonizuar këto dy interesa, plus aspekte të tjera pastaj që u diskutuan nga kolegët dhe unë nuk po dëshiroj të zgjatem. Mbetemi këtu atëherë.

E mbylлим edhe këtë projektligj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.05.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për turizmin”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Pandeli Majko, Ulsi Manja

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ervin Mete - zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Sonia Popa - drejtore e Përgjithshme për Turizmin

Alma Baze - drejtore e Standardizimeve për Turizmin

Enton Diamanti - përgjegjës Sektori për Turizmin

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin tjetër “Për turizmin”.

Zoti Ministër, mund të bëni një paraqitje të projektligjit? Ky është një projektligj tejet i rëndësishëm për shkak sepse është një ligj kuadër në një fushë shumë sensitive për ekonominë e vendit, dhe më shumë se kaq. Ka dhe një arsye më shumë. Ky ligj shfuqizon ligjin kuadër që kemi pasur deri tani. Që do të thotë se është një ligj, i cili do të duhet të mbajë në konsideratë aspektet pozitive në këtë fushë, por kryesorja ajo që është më e rëndësishme, të reflektojë defektet, dobësitë, mangësitë që kemi pasur për t’i dhënë një hov zhvillimit të turizmit, si një degë e rëndësishme e zhvillimit të ekonomisë dhe shoqërisë. Zoti Ministër.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Unë do ta nis aty ku ju e latë me të drejtë, që projektligji që ne paraqesim përpara jush është munduar të reflektojë të gjithë atë eksperiencë 22-vjeçare, aty ku kemi pasur defektet, apo aty ku kemi pasur suksese për aty sa kemi pasur dhe për t’i integruar në këtë draft të ri që të kemi mundësi të afrojmë një platformë juridike, pra një platformë ligjore ku industria e turizmit të bazojë veten në zhvillimin e mëtejshëm të saj. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik dhe të tërheqë vizitorë vendas dhe të huaj duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm dhe gjithëvjeter.

Ky ligj rregullon veprimtarinë e sipërmarrjeve turistike për investitorët vendas dhe të huaj duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt. Ligji bën një përpjekje shumë serioze për këndvështrimin tim të arrirë të definimit të të gjithë elementëve të industrisë. Janë gati 52 definicione shumë të qartë në hyrjen e ligjit që bëjnë të mundur largimin e çdo konfuzioni në të kaluarën qoftë për procedurat, qoftë për proceset, qoftë për definicionet të cilat i kemi përdorur rëndom gjatë 20 vjetëve, por nuk kanë qenë të definuar në ligj.

Në të njëjtën kohë ligji sqaron drejtpërdrejt ndërvlerësinë e institucioneve shtetërore qoftë në nivel qendror qoftë në nivel lokal. Për herë të parë në këndvështrimin tim i vendos institucionet në zinxhir apo në krah të njëri-tjetrit në mënyrë shumë të qartë jo duke krijuar përplasje, por duke krijuar harmoni në favor të zhvillimit të turizmit. Draft-ligji sjell edhe standardizimin dhe sistemin e të gjithë operatorëve që funksionojnë në fushën e turizmit. Pra, certifikimi dhe licencimi i subjekteve në fushën e turizmit është një nga elementët kryesorë të këtij ligji. Kategorizimi dhe klasifikimi i strukturave akomoduese, pra vendosja e yjeve, për

herë të parë futet në një shtrat juridik të qartë dhe pikëzimin për yjet do ta bëjmë në bashkëpunim të drejtpërdrejt me kompani sot shumë të mirënjohura në botë që bëjnë dhënie e yjeve jo vetëm në rajon, por në Europë apo edhe globalisht.

Certifikimi i udhërrëfyesve të turizmit është një nga elementet teknike, të drejtpërdrejta të ligjit dhe të gjitha këto përbëjnë dhe arsyet e drejtpërdrejta pse ne vendosëm të hartojmë një ligj të ri për turizmin. Por çka është më e rëndësishmja në arsye është lehtësimi i investimeve në turizëm. Shqipëria është në një rajon tejet konkurrues për tërheqjen e investimeve në turizëm. Dhe do të duhet të jemi të sigurtë dhe të drejtpërdrejtë që zhvillimi i industrisë së turizmit në vendin tonë ka qenë jashtëzakonisht shumë modest në krahasim me zhvillimet turistike, me zhvillimet e Ministrisë së Turizmit në Mal të Zi, Kroaci, Greqi dhe në Turqi apo dhe përballë në anën tjetër të Adriatikut në Itali që është komplet një tipologji, profil dhe fenomen ndryshe turistik nga ajo që dhe sot po tentojmë që të krijojmë.

Kapitulli për investimet është një kapitull i drejtpërdrejtë mbështetës ku përcakton qartë investitorin si të parin për t'u mbështetur. Afron mundësinë e vënies në dispozicion të terreneve publike për atë sa kemi, gjithmonë me garë. Mënyra e garës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në reflektim të drejtpërdrejtë do të përdorim personin, mënyrën se si Kroacia afron terrenet turistike, shtetërore për zhvillim turizmi.

Dua të them që ligji i turizmit është harmonizuar me disa ligje të tjera, qoftë me ligjin e partneritetit publik privat ose me ndryshimet që po vijnë shumë shpejt në parlament, qoftë me investime në ligjin që sapo diskutuam për investimet strategjike.

Sfida, të nderuar deputetë, është jashtëzakonisht shumë e madhe në turizëm. Kemi debatuar jashtëzakonisht shumë gjatë. Kemi parë dhe krahasuar të gjitha eksperiencat e rajonit dhe kemi vendosur që të paraqesim në parlament një draft-ligj, i cili afron një ofertë jashtëzakonisht shumë liberale për investitorët. Kemi debatuar jashtëzakonisht shumë për mënyrën se si do të zhvillohet turizmi. A do të lejojmë më ato që kemi lejuar deri tani ku ndërtohej le të themi një fshat turistik, i cili shitej i gjithi dhe funksiononte 40 apo 60 ditë në vit dhe 300 ditët e tjera ishte qytet apo fshat fantazmë që nuk i sillte asnjë të mirë për zhvillimin ekonomik, nuk sillte asnjë të mirë për zhvillimin e turizmit, por thjesht okuponte terrene publike apo jopublike? Apo do të lejojmë sërish atë zhvillim që shëmbëlltyra, në këndvështrimin tim më të keq është Golemi i Durrësit, ku zhvillimi kaotik ka shkatërruar Golemin si destinacion turistik dhe është e pamundur për të kaluar në një turizëm nga popullor në elitë ku të përfitohen shumë më shumë të ardhura për zhvillimin ekonomik dhe për prodhimin e brendshëm bruto? Dhe ligji i jep të drejta qeverisë që më në fund jo vetëm të korrektojë, por dhe ta stabilizojë të gjithë atë dhe ta fusë në rrugë të disiplinuar duke iu

referuar interesave të zhvillimit ekonomik dhe të industrisë së turizmit, gjithë atij zhvillimi jo vetëm në bregdet, por edhe në zonat e tjera turistike. Koncepti i zonës me përparësi turizmi nuk është thjesht koncept teknik është dhe koncept disiplinimi se fakti është fakt, debati mund të jetë si të duam këtu, jo pushteti vendor, jo pushteti qendror, por fakti është fakt. Pushteti vendor në shumicën e rasteve ia ka dalë ta shkatërrojë bregdetin e Shqipërisë. Dhe dilema do të ishte nëse do ta lejojmë ose jo.

Të vazhdoj më tej. Këshill i Ministrave ka vendosur të paraqesë përballë jush një paketë e cila e disiplinon përfundimisht dhe nuk është një paketë të cilën e kemi shpikur ne, është një paketë, e cila është parë në vende të ndryshme pikërisht për të frenuar zhvillimin kaotik, i cili betonizon territorin turistik.

Në të njëjtën kohë, bën disiplinimin e operatorëve turistikë, në favor të rritjes së cilësisë së turizmit. Kemi parë histori të çuditshme, ku kompanitë eudhëtimit apo operatorët e tjerë turistikë kanë abuzuar me grupet turistike, duke i lënë edhe në mes të rrugës.

Ligji detyron disiplinimin dhe përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të këtyre operatorëve. E gjithë logjika e këtij ligji është të krijojë një platformë parimore të zhvillimit të turizmit. Nuk është se ligji do të sjellë nesër, menjëherë, investitorë me nga 1 -2 miliardë, por ai definon shtatin ligjor, juridik, procedural për ta vendosur e turizmin në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe një turizmi gjithëvjetor.

E thashë që jemi konsultuar me shumë aktorë vendas, me industrinë e turizmit dhe me donatorë, si BB-ja me të cilën jemi konsultuar prej disa muajsh (4 muajsh), për të sqaruar, përmirësuar dhe definuar koncepte apo përkufizime që ligji i ofron.

Për informacionin tuaj, jemi duke zhvilluar edhe një projekt të ri për turizmin me BB-në, i cili është fokusuar në krijimin e një cirkuiti turistik, duke filluar që nga Bregdeti i Jugut dhe duke bërë xhiron e qendrave të mbrojtura kulturore të mbrojtura nga UNESCO, si Gjirokastra, Berati apo më lart, me synimin për të ofruar një turizëm gjithëvjetor dhe për të ofruar një disiplinim të zhvillimeve turistike, në mënyrë që zhvillimi i turizmit të jetë i qëndrueshëm dhe jo kaotik dhe rastësor.

Më duhet të them, gjithashtu, se kjo është e lidhur edhe me 1 element të ligjit të lojërave të fatit. Resortet apo hotelet me 5 yje, që definoohen të tilla pasi certifikohen, marrin menjëherë një licencë kazinoje vetëm në zonat me përparësi turizmin.

2 janë arsyt kryesore:

- Të ndihmojë investitorët e fushës së turizmit, që ata të kenë një kthim më të shpejtë investimi. Dua të ndaj një informacion teknik me ju, i cili është shumë i rëndësishëm dhe në gjykimet që kemi, kur vendosim qoftë terminologjinë, qoftë procedurat, qoftë parimet.

Në unazën e Mesdheut dhe këtu fus Kroacinë, Malin e Zi, Shqipërinë, Greqinë dhe Turqinë, kthimi i investimit në standard, shkon gati 15-16-17 vjet.

Nuk vjen njeri të investojë në Malin e Zi apo në Shqipëri për të pasur një kthim investimi për 15-16-17 vjet. Ne jemi në një zonë me konkurrencë shumë të fortë.

Parë dhe thënë këtë që thashë, oferta është pa kufizime. Pra, oferta jonë është pa kufizime dhe Këshilli i Ministrave (unë e kam biseduar në pozitivistet edhe me deputetë të opozitës në rastësi, por në themel shumë të detajuar), se çfarë ofrojnë vendet e tjera.

Ligji i hap rrugën qeverisë shqiptare të bëjë oferta shumë konkurruese, në krahasim me vendet e tjera, pa vënë kufizime dhe qëllimi është që të ulim për investorët kohën e kthimit të investimit, në mënyrë që ta kthejmë vendin në një destinacion me atraksion turistik.

Dua të ndaj me ju me kënaqësi, gjithashtu, se vitet e fundit kanë njohur një rritje të numrit të turistëve dhe një zgjatje të stinës turistike.

Jugu i Shqipërisë, sidomos destinacionet kulturore, siç janë Gjirokastra dhe Berati, nëse çdo vit e kanë njohur fillimin e stinës turistike në fund të majit, në vitin e kaluar dhe këtë vit, fillimi i stinës turistike ka qenë në mars. Kjo ndihmon drejtpërsëdrejti zhvillimin ekonomik të atyre rajoneve. Thënë kjo, në statistikë, 37% e turistëve janë turistë kulturorë dhe nuk janë thjesht, turistë për rërën apo për detin.

Në të njëjtën kohë, dua të them se edhe në kapitullin për investimet e huaja, zgjidhim edhe ato dilema që u përmendën edhe në diskutimin për investimet strategjike.

Dua t'ju sjell një shembull, i cili është tregues: nëse më parë një investor vinte dhe ndërtonte një hotel me 4 apo 5 yje në breg të detit dhe konkurronte për këtë, e fitonte dhe zhvillonte, përballë tij, në det, mund të ndërtonte kushdo një port jahtesh, në kundërshtim me logjikën investuese të resortit apo të hotelit, apo mund të ishte një investor me interesa tërësisht të kundërta dhe të krijojë konflikte investitorësh.

Ky ligj e zgjidh këtë. Nëse një investor vjen me ofertë për të ndërtuar një resort apo një hotel dhe një marinë jahtesh, projekti nuk është më në 2 pjesë, ku do të konkurrojë më vete për hotelin, dhe më vete për marinën, por do të jetë një projekt i integruar.

Nëpërmjet këtij ligji zgjidhim edhe atë që u përmend pak më parë këtu, përdorimin e rërës. Pra, investitori merr të drejtën e përdorimit të rërës, kur ndërton një hotel këtu dhe jo hoteli të ndërtohet këtu, ndërsa rërën para tij e merrte i forti i lagjes, për ta dhënë me qira.

Ndërtohet hoteli dhe rëra para tij i jepet zhvilluesit të hotelit, në mënyrë që të krijohet një harmoni në zhvillimin e projektit. Pra, janë zgjidhur edhe dilema, të cilat janë bërë pjesë e përpjekjeve 22-vjeçare dhe kanë pasur problematikat e veta.

Fakt është që ne nuk ia kemi dalë në turizëm gjatë këtyre 22 vjetëve që të ofrojmë investime serioze, strategjike të mëdha, që do të sillnin zhvillim ekonomik dhe rritje të numrit të turistëve, por kanë qenë përpjekjet e privatëve në të gjithë territorin e Shqipërisë, qoftë në det, qoftë anës së liqeneve, qoftë në destinacionet kulturore me ato *bed and breakfast*, me hotele shumë të mira, por të vogla, që e kanë rritur numrin e turistëve në rreth 3 milionë, por kjo është faza e dytë dhe thënë kjo, jemi akoma larg konkureshmërisë së rajonit. Për këtë arsye, para se ta mbyll, dua të ndaj me ju informacionin që Ministria e Turizmit, këtë javë që po flasim, paraqet në Interministerialin e Ekonomisë paketën për mbështetjen e turizmit, ku ka 22 masa të drejtpërdrejta në mbështetje të industrisë, të cilat u janë referuar eksperiencave dhe praktikave më të mira të rajonit.

Në të njëjtën kohë (e theksova edhe te Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese), jemi në negociata të vështira, por shumë këmbëngulëse me koncesionarin e aeroportit, për të çliruar qiellin. Koncesionari i aeroportit ka ekskluzivitet, por pa aeroporte ndërkombëtare *low cost* turizmi, zëre se ecën me një këmbë. I gjithë debati që kemi me koncesionarin, është për të rifituar qiellin dhe për të lejuar 2-3 aeroporte në Veri dhe në Jug të Shqipërisë, pikërisht, me qëllim rritjen e numrit të turistëve, sepse fatkeqësisht, aeroporti shqiptar është akoma një nga më të shtrenjtët në rajon dhe një nga më të shtrenjtët në Europë.

Mbetem i hapur për pyetje apo për sqarime të mëtejshme.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori i projektligjit, zoti Fino.

Bashkim Fino – Relacionin e keni përpara. Unë s’kam ndonjë gjë dhe projektligji është në mbështetje të Kushtetutës. Qëllimi i projektligjit është shumë i mirë, por do të doja të bëni më shumë pyetje, për të sqaruar ndonjë paqartësi që kemi dhe më pas, për të diskutuar.

Edhe unë, si relator, kam disa pyetje.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Do të filloni ju me pyetjet apo do të prisni t’i bëjnë të tjerët?

Edhe në projektligjin e mëparshëm, filluat ju me pyetje.

Atëherë, mund të filloni ju nga pyetjet.

Bashkim Fino – Qëllimi i projektligjit është shumë i mirë dhe natyrisht, të gjitha ato që tha ministri qëndrojnë dhe është gjë shumë e mirë që po bëjmë një ligj të ri kuadër për turizmin, por përtej kësaj, se ministri shikon vetëm pjesën e vet, unë do të bëja një pyetje më globale.

Zoti Ministër,

Ne kemi miratuar një reformë territoriale në Shqipëri, e cila do të bëhet efektive më 21 qershor, ku do të dalin 61 kryetarë bashkie.

Ne kemi miratuar para 1 viti (në 2014-n), ligjin “Për planifikimin e territorit”, që duam, s’duam, edhe ai e prek ligjin “Për turizmin”. Në kuadër të ligjit të mëparshëm dhe në kuadër të ligjit të dytë, por edhe në kuadër të fuqive që duam t’u japim kryetarëve të bashkive për decentralizimin dhe për kompetencat mbas 21 qershorit, kam përshtypjen se shumë kompetenca centralizohen në projektligjin “Për turizmin” dhe mbase kështu duhet, në fazën e parë dhe nuk do të isha kundër vënies së theksit të roli të ministrisë, por më lejoni të pyes për 2 çështje, që mua më duket se bien në kundërshtim të hapur me pushtetin vendor: shkelja e hapur e të drejtave të qeverisjes vendore të nenit 33 të projektligjit, “kalimi në administrim të Ministrisë për Turizmin, të pronave në zonat turistike”, thuhet në këtë projektligj.

Unë mendoj se kjo është në kundërshtim edhe me ligjin “Për planifikimin e territorit”, që e kemi kaluar, edhe me ligjin nr 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të cilat me këtë ligj, që ne po kalojmë, janë në kundërshtim. Ky ligj është një ligj i thjeshtë, ndërsa ligji nr. 8652 është një ligj i cilësuar dhe i votuar me 3/5.

Çështja e dytë: A është shkelje e kompetencave të pushtetit vendor në fushën e planifikimit të territorit, detyrimi për marrjen e pëlqimit nga Ministria e Turizmit për ndërtimin e strukturave akomoduese, jashtë zonave me përparësi turizmin?

Ju thoni në një ligj të caktuar, në nenin 41 që lejet e ndërtimit për struktura akomoduese, jashtë zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, në rastet kur jepen nga autoritetet vendore të planifikimit, duhet të marrin pëlqimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për turizmin. Mirë në vendet me përparësi turizmin, por edhe jashtë kësaj zone, duhet të marrë lejen e ministrisë?

Mua më duket se po e centralizojmë pushtetin dhe nuk po i lëmë një hapësirë. Ne e bëmë gjithë këtë reformë ta quajmë më të çliruar kryetarin e bashkisë, të ketë më shumë kompetenca, të jetë baras me ministrat. Për mua, 61 kryetarë bashkish janë të barabartë me aq ministra, sa ka qeveria “Rama” nga pikëpamja e territorit, e njerëzve që drejtojnë dhe e aseteve që do të kenë në atë bashki të caktuar.

Pyetja e tretë: Në projektligj përdoret shpesh termi “vënie në dispozicion e pasurisë së paluajtshme shtetërore”. Çfarë keni parasysh me këtë term? Dhënien me qera apo ndonjë formë tjetër, sepse në legjislacionin shqiptar ky term nuk njihet? Është fjala për nenin 34 të projektligjit.

Kur ia vë në dispozicion, ia jap me qira apo ka ndonjë formë tjetër ?

Tjetër pyetje që kam dhe që dua një përgjigje: Unë e kuptoj dhe kam qenë vetë ministër i Turizmit për një farë kohe, por nuk e kuptoj nën 30, pika 4, ku thuhet, se projektet e turizmit me fonde buxhetore nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik, pra përjashtohen nga procedura e prokurimit publik?

Çfarë ka ndodhur në praktikë, që ne duhet të anashkalojmë procedurat e prokurimit publik dhe bëjmë veprimet? Duhet të na jepni statistika dhe të dhëna, që të na e mbushni mendjen për një gjë të tillë.

Pyetje tjetër: A mund të na shpjegoni se çfarë është regjistri i veçantë që duhet të kryehet në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për pasuritë që ndodhen në zonat me përparësi turizmin? Neni 40 i projektligjit.

Në fund, te neni 17 i projektligjit, desha të di si do të funksionojë Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike? Mbi bazën e cilave standarde do të funksionojë certifikimi i veprimtarisë turistike?

Këto pyetje janë edhe teknike, kanë të bëjnë me projektligjin, por mua më shqetëson më shumë koordinimi më i plotë i ligjit të vitit 2014 “Për planifikimin e territorit”, ndarjes territoriale që kemi bërë dhe që jemi në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e 21 qershorit dhe ligjit “Për turizmin”, në mënyrë që të jenë në sinkron me njëra-tjetrën dhe të mos ketë përplasje as mes pushteteve, as midis këtyre ligjeve.

Ju, si ministër, jeni pjesë përbërëse e Këshillit të Rregullimit të Territorit dhe nuk mendoj se ky ligj do të jetë një ligj që të na lejojë të japim vetëm leje ndërtimi në zonat me përparësi turizmin. Edhe në zonat pa përparësi turizmin, mund t’i thuash pushtetit vendor: “Më merr leje mua në fillim!”

Ne duam të mos ketë përplasje mes ligjeve apo institucioneve të tjera, siç janë edhe ministria apo organet e pushtetit vendor, të dalin nga zgjedhjet e 21 qershorit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Urdhëroni, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zoti Fino!

Do t’i referohem zonave me përparësi turizmin, ku ju thoni se ka një konflikt me pushtetin vendor.

Ne besojmë se kjo është një masë e domosdoshme dhe e kemi sjellë me bindje të plotë se për fazën që po kalon turizmi në Shqipëri dhe për dëmin që ka pasur territori, për shkak të zhvillimit kaotik dhe për shkak se tashmë turizmi konceptohet si sektor strategjik,

kalimi në administrim, presupozon ruajtjen nga një zhvillim kaotik dhe është i harmonizuar me të dy ligjet e tjera, edhe me ligjin “Për planifikimin e territorit”. Kemi debatuar shumë për këtë pikë dhe kur e kemi sjellë projektligjin para jush, e kemi sjellë me bindje, duke iu referuar edhe historisë 22-vjeçare (siç tha me të drejtë zoti Xhafaj), e cila në shumicën e rasteve zhvillimin e territorit në dorë të njësive vendore, ka treguar se është influencuar nga interesa të vogla, përtej zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Thënë kjo, ne besojmë se është në harmoni me 2 ligjet e tjera.

Sa i takon pëlqimit, është interesante se ministri i Turizmit nuk jep asnjë leje, nuk miraton asnjë projekt. Këtë e bën Këshilli i Ministrave, por pëlqimin...

Do t’ju a sjell shembullin se përse është kështu. Është parë në territor qoftë në Kroaci, qoftë në Turqi. Në një zonë me përparësi turizmin, ku zhvillimi është fokusuar në turizëm elitare me 5-6 yje. Në kufi me të ka një turizëm në formë moteli pa yje, me standard bazë. I bie që niveli i asaj zone të jetë me 3 yje, ndërkohë që dikush brenda zonës ka harxhuar 100 milionë dhe e ka kthyer në destinacion turistik dhe dikush ka harxhuar gjysmë milioni dhe ka prishur ambientin për turizëm të qëndrueshëm, edhe për atë tjetrin që ka harxhuar 100 milionë. Pra, kemi parasysh këtë rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, nuk është kompetencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, asaj iu referova. Shembulli është që nëse brenda një zone turistike...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Është shumë e saktë kjo që thotë zoti Peza. Shembulli është që në kufijtë e zonës turistike të ketë zhvillim, i cili nuk reflekton atë objektiv që ka turizmi, por e dëmton atë. Është një lloj sikur (po ju sjell një shembull se fatkeqësisht e kemi akoma në Shqipëri). Mu në kufi të Porto Montenegro, bëhet një kioskë turistike, e cila shkatërron të gjithë atë investim prej qindra milionë dollarësh.

Kjo është logjika. Ministri jep pëlqimin dhe jo lejen.

Përfundimi nga procedura nuk ka absolutisht. Vënia në dispozicion është e gjitha me garë. Shembulli më i mirë janë Kroacia dhe Mali i Zi, kur hapin garë për terrenet publike. Ne nuk e kemi pasur në asnjë klauzolë që t’i referohet tokës publike në bregdet, apo terreneve publike në bregdet. Këshilli i Ministrave me vendim, rast pas rasti, vendos kriteret dhe procedurën e garës. Për ta ilustruar po ju sjell një shembull: gara do të jetë, po e marr për ilustrim, për 100 hektarë në bregdet, tokë publike, investimi, projekti, punësimi, zhvillimi

gjithëvjeter, pra do të ketë një sërë elementesh të pikëzuara, kur vendos në dispozicion me garë, në çdo rast, të tokës publike.

Ju, iu referuat nenit 40 dhe ju falënderoj për pyetjen, pra ju, i referoheni nenit 40, ku janë zonat ku nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, ju e dini po aq mirë sa unë procesin dhe procedurën e regjistrimit fillestar. Por, në qoftë se në një zonë, ku kërkohet një projekt strategjik dhe një projekt i zhvillimit të turizmit, atëherë kjo detyron autoritetet të bëjnë brenda 3 muajve regjistrimin brenda zonës me përparësi të turizmit, brenda 3 muajve duhet të sqarojnë gjithçka, tani në këtë fazë ekonomike është Shqipëria, nuk mund të presi një investim, po e marr për ilustrim sërish, për 100 milionë euro, që të vazhdojë administrata shqiptare të sqarojë regjistrimin pas 3 vjetësh.

Ne jemi në garë me kohën, edhe me fqinjët dhe në qoftë se nuk mundim dot këtë garë me kohën, mbi të gjitha, dhe kapim dhe tejkalojmë ritmin e fqinjëve, atëherë ekonomia shqiptare është e mbaruar. Ju e dini po kaq mirë sa unë, që çështja e regjistrimit të tokës është kthyer në problem, në bagrem, madje. Kjo ishte. Nuk e di nëse arrita t'ju kënaq qoftë në pyetjet, qoftë në dëshirën për të ditur detajet teknike, kuptohet në diskutimin nën për nen kemi mundësi, që edhe t'i definojmë teknikisht akoma më mirë. E njëjta gjë vlen edhe për certifikimin, pra është ligji i licencave në Republikën e Shqipërisë, se atij i referohemi, por këto do të jenë certifikime kryesisht dhe jo licenca, shumica e tyre do të jenë certifikime që do të jenë shumë të thjeshta *online* dhe do të ndjekim të njëjtën logjikë, për përshpejtimin e dhënies së licencave, që ekziston edhe sot, por që ka nevojë të standardizohen dhe të disiplinohen, unë në këndvështrimin tim nuk kam diskutim.

Besoj se në këndvështrimin tim, iu përgjigja të gjitha pyetjeve, që ju bëtë, zoti Fino, nuk shoh që të kem lënë ndonjë pyetje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Pyetje, zoti Mediu, pastaj zonja Hysi.

Fatmir Mediu – Zoti Ministër, ju thatë që ne jemi në garë me fqinjët dhe me kohën. Dhe të jemi në garë me fqinjët të paktën duhet të bëjmë disa krahasime, për të bërë të mundur që të thithim investime në turizmin në Shqipëri.

Ju po ashtu theksuat që kthimi i investimeve në vendet fqinje, është 16 -17 vjet në fushën e turizmit. Konceptohet dhe është i analizuar, ndoshta dhe më shumë se kaq. Problemi është që 16-17 vjet, me një taksë që në vendet fqinje është afërsisht 9%, në një kohë që ne kemi taksë 15%.

E para, mendoni që taksa në Shqipëri është pengesë në raport me konkureshmërinë me vendet fqinje?

E dyta, vendet fqinje po aplikojnë që *ritëm ofinvestëm* të jetë shumë herë më e shkurtër, të ulin tek 5%-7% TVSH-në dhe ju kam dëgjuar dhe ju që TVSH-ja në fushën e turizmit duhet ulur, e mbështes idenë. Ne kemi një TVSH shumë të lartë në fushën e turizmit, prandaj po e ulim nga 19%-20%, në 5% -7%. A keni parashikuar ju, që përveç këtij projektligji nga pikëpamja e një pakete financiare, e cila bën shumë të vlefshëm investimin në turizëm, të parashikohet ulja e TVSH-së, në fushën e turizmit! Njëkohësisht jo vetëm kaq, por vendet fqinje kanë parashikuar dhe zona me taks zero, për një periudhë kohe 5-10 vjet për të rritur interesin për investime në zonat malore, apo në zona të cilat padyshim, kanë ato karakteret e zhvillimit të turizmit, por janë në një zhvillim ekonomik më pak të favorshëm sesa zonat bregdetare. Për shembull, po marr Malin e Zi. Është parashikuar nga ana juaj, flas iniciativa, si ministër, që të futeni edhe në këtë fushë të një pakete financiare për t'i mbështetur, pavarësisht se kush është qëndrimi i ministrit të Financave, apo i qeverisë në përgjithësi, rreth kësaj çështjeje?

Gjithashtu, kur synohet të ndërtohet një turizëm, i një niveli të mirë, do të thosha, nuk po e konsideroj elitare, parashikohet edhe pak a shumë ç'lloj turizmi do të ndërtojmë, që të mos i ngelemi rastësisë nga pikëpamja e resorteve, por edhe nga pikëpamja e hotelerisë. Për shembull, me sa shoh unë, ne i referohemi hotelerisë klasike, në një kohë që fqinjët tanë jo vetëm Mali i Zi, por edhe Kroacia, i janë afruar konceptit të *condo minium hotels*, të cilët kanë një rentabilitet tjetër në kthimin e investimit jo vetëm, *time share* por edhe *trading pools* të gjitha çfarë janë. Po i marr njëkohësisht, për shembull, po flas investimi që sot është **porto fondinever** që ju përmendët, si vlerë investimi është në vlerën e 500 milionë euro dhe pse është investuar afërsisht gjysma, vlera investimit sot kap vlerën rreth 700 milionë. Pra është rritur si vlerë nga pikëpamja e interesit dhe investimeve të tjera strategjike. Pra them, a ka nevojë edhe për një paketë financiare dhe një koncept tjetër, për ta bërë atraktive Shqipërinë që duhet padyshim parashikuar edhe në legjislacion?

E rëndësishme është,që ligjet bazë në këtë vend, siç është ligji i prokurimeve publike, ose duhen respektuar, ose duhen ndryshuar.

Neni 30 pika 4, që u përmend këtu edhe nga kolegët, parashikon injorimin e ligjit për prokurimet publike. Kjo nuk mund të bëhet këtu, në qoftë se ka nevojë për t'u ndryshuar, duhet ndryshuar ligji i prokurimeve publike, i cili ka parashikuar përjashtimin nga ligji i prokurimeve publike, të gjitha prokurimet që ka të bëjnë me çështjet të sigurisë. Ka qenë një

debat shumë i fortë me BE-në, kur është bërë ky ligj, se kush duhet dhe kush nuk duhet përjashtuar nga ky proces. Pra, e keni konsultuar këtë dhe a bie ndesh me ligjin?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër!

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zoti Mediu!

Ne edhe së bashku kemi debatuar, në fakt, për turizmin disa herë, për sa i përket domosdoshmërisë për një paketë mbështetëse për industrinë, kjo është absolute po. Unë e përmenda jo pa qëllim se gjatë kësaj jave do të paraqes në interministerialin e ekonomisë, ku bëjnë pjesë gati 8 ministra, një paketë e cila ka dhe propozime financiare për mbështetjen. Midis të tjerave, unë i referohem edhe direktivës së Bashkimit Europian për TVSH-në, e cila nuk është për Shqipërinë detyruese, por është referuese ku thotë që; TVSH-ja në turizëm nuk mund të jetë më shumë se 15%. Vendet e rajonit e kanë 6%, 7%, 9% e kanë 10% dhe besoj që do të gjej dhe mbështetjen e kolegëve. Brenda paketës ka edhe elemente që ndihmojnë turizmin gjithëvjetor, në një koncept jo thjesht kostal, por në të gjithë vendin. Po ju sjell një shembull për ta ilustruar, në qoftë se je në një zonë ku turizmi është sezonal, je në bregdet, duke filluar nga 1 tetori deri në 30 prill, ti nuk paguan sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit shtesë që ke marrë gjatë sezonit, gjatë pikut të sezonit, pra për të tentuar, për ta mbajtur hapur. Por ka dhe elemente të tjerë, sa të duash, brenda asaj pakete, të cilat shkojnë te produktiviteti i industrisë, tek ajo që ne debatojmë për të ulur numrin e viteve të kthimit të investimit, ndryshe nuk do të kemi dot investime serioze.

Brenda ligjit, është dhe koncepti që ju me të drejtë e sollët këtu, Kroacia koncepti i *kontaminimit* dhe *tajmsher* dhe *kondominium* janë të parashikuara si definicione brenda këtij ligji për t'u lejuar. Ne kemi pasur një debat brenda Këshillit të Ministrave, për të filluar dhe menduar kufizimin e shitjes dhe e nisëm me 35% dhe e çuam 70% dhe vendosëm rast pas rasti, sepse pamë një eksperiencë shumë frytdhënëse që e ka Mali i Zi. Ai i trajton investimet sidomos ato që definoohen dhe si investime strategjike rast pas rasti. Kjo është dhe arsyeja që për herë të parë investitorët do të bëjnë një kontratë, pra do të kenë marrëdhënie kontraktuale me qeverinë e Shqipërisë, për të gjitha ato që do të ketë të parashtruar në programin e investimit.

Edhe licenca e kazinosë falas është një nga elementet për të ulur kthimin e investimit në vite, që të shkojë nga 16% apo 17%, te 9% apo 10%, se vendet e ndryshme që kanë dhe 0, taksa përveç që e kanë te 7%-8% kanë mundësi që t'u japin dhe subvencione, Turqia u jep subvencione të drejtpërdrejta, Kroacia deri vonë ka dhënë mbështetje të drejtpërdrejte buxhetore për ndërtimet në hoteleri dhe në turizëm.

Dua të sqaroj një element, për sa i përket prokurimit publik. Për nenin që ju iu referuat, i cili është neni 30 pika 4. Bëhet fjalë vetëm për fondet e promovimit të turizmit dhe po ju sjell një shembull, ne ishim në ITB, në Berlin dhe po tentonim që prokuronim një ekran *led*, nuk kemi asnjë mënyrë sesi ta prokurojmë në Berlin. Ne duam të promovomë për shkak të ndryshimit të tipologjisë së turistëve, që shumica janë nordikë nga vendet e Europës Veriore, polakë, çekë, slloven, italianë apo boshnjak, ne duam të bëjmë një promovim të destinacionit të Shqipërisë në televizionet e tyre. Pra, jemi duke folur për projektet e promovimit dhe në fakt, është marrë *mot a mo* ajo që qeveria e kaluar ka bërë me ligjin për kulturën, për bienalet, pra nuk është se po bëjmë ndonjë shpikje të re.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për mua, është dhe logjika e drejtë e zotit Xhafaj, që thotë se po të kishim një ligj kuadër nuk do t'i bënim të gjithë investitorët që të marrin një tufë me ligje në dorë dhe kjo është dhe arseja. Ka pasur shumë vështirësi Agjencia Kombëtare e Turizmit për të promovuar, se nuk arrin dot, realisht. Kjo është edhe logjika e asaj klauzole. Faleminderit!

Nuk e di lashë ndonjë nga pyetjet tuaja pa iu përgjigjur, shpresoj jo.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë ju uroj për projektligjin që keni sjellë, pasi e vlerësoj shumë të rëndësishëm për të zgjidhur problemet, të cilat janë me interes për të gjithë.

Kam disa pyetje që lidhen me disa agjenci ose komitete, të cilat krijohen në varësinë e ministrisë suaj, zoti Ahmetaj. Në të gjitha ligjet e tjera, ku krijohen agjenci varësie, ne në ligj kemi përcaktuar përbërjen e komitetit, të këshillit, të agjencisë, parimet e funksionimit dhe kompetencat për detyrat dhe përgjegjësitë. Do të ndalem te neni 11. Në të gjitha ligjet e mëparshme, që kemi miratuar ne këtu në komision, aty ku krijohen agjencitë ose komitete në varësinë e një ministrie të caktuar, kemi ndjekur si rregull, përcaktimin e emërimit, të varësisë të statusit që kanë punonjësit, të detyrave dhe përbërjen. Për shembull, numrin nga sa përbëhet një komitet, një agjenci sa janë nga sektori publik, sa janë nga sektori privat.

Nëse i referohemi nenit 11 të Komiteti Këshillimor, i sektorit privat të turizmit, që e vlerësoj një gjetje shumë të mirë, mungojnë dy elemente të rëndësishme.

E para, e kam fjalën për pikën 3 të këtij neni, raporti midis përfaqësuesve të institucioneve të donatorëve, me përfaqësuesit e shoqatave kombëtare të sipërmarrjes ose atyre që operojnë në fushën e turizmit.

E dyta, nuk gjej në ligj shmangien e parimit të konfliktit të interesave. Në shumë nene përmendni shoqatat e turizmit, sipërmarrjen, por nëse ato do të jenë në vendimmarrje, qoftë ai shqetësimi që ngritën zoti Fino dhe zoti Mediu, që do t'i kthehem edhe unë, te neni

30, i bie që këta persona, të cilët do të emëroni në komitete ose në borde, nuk do të ushtrojnë veprimtari në sektorin e turizmit në bazë të ligjit “Për konfliktin e interesave”. E përmend këtë gjë, sepse ne jemi komisioni që e shikojmë ligjin nga pikëpamja kushtetuese në raport me ligjet e tjera. Nëse ju e bëni këtë ligj, më falni që e them, por do të keni vështirësi, do t’ju bllokojë ligji “Për konfliktin e interesave” ose për persona që deklarojnë pasuritë, ILDKP-ja nuk lejon, pa dashje do t’i vendosni njerëzit në konflikt me ligjin. Prandaj duhet të rregullohet neni 11, në çfarë raporti do të jenë ata që do t’iu këshillojnë juve? Sa do të jenë përfaqësues të shoqatave, të institucioneve, të donatorëve? Çfarë veprimtarie mund të zhvillojnë ose çfarë nuk duhet të zhvillojnë ata?

Kalojmë te një nen tjetër. Drejtori i Përgjithshëm Agjencisë Kombëtare të Turizmit. Ne kemi një agjenci, kemi edhe një drejtor. Parimi i sigurisë juridike, çfarë do të bëhet me drejtorin apo drejtoreshën aktuale? Më falni, nëse e kam gabim. Duhet të ketë një drejtor të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

Në nenin 13 thoni që emërimi dhe lirimi i drejtorit të Përgjithshëm të AKT-së bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Do të jetë me statusin e nëpunësit civil? Për cilin ligj flisni? Pra, duhet të përcaktohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Fino, ju keni shumë të drejtë.

Përgjigjja që jepni tani është e saktë, por duhet të përcaktohet. Po për stafet? Duhet të zgjidhet problemi. Në këtë ligj nuk shoh në asnjë rast rregullime, referime te ligji “Për nëpunësin civil” apo te ligjet e tjera. Si e keni vlerësuar ju?

Dua të kaloj te një nen tjetër. I rikthehem çështjes së zotit Fino, raportit të ministrisë me njësitë e qeverisjes vendore. Në nenin 18 ju kërkoni që organet e qeverisjes vendore çdo dy muaj të krijojnë inventarin e burimeve kryesore turistike dhe të përcjellin periodikisht inventarët pranë ministrit përgjegjës. Në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, zoti Fino e di më mirë, sepse e ka hartuar vetë atë në vitet 2000, nuk ka ndonjë detyrim të tillë. Ne me këtë ligj që votohet me një shumicë të thjeshtë cenojmë një ligj, i cili është votuar me shumicë të cilësuar, ndërkohë që ideja është se ky ligj do të vijë në muajin shtator dhe do të rregullohet.

Cili është interesi që çdo dy muaj të bëhet inventari? A mund të ndryshojnë këto burime turistike çdo dy muaj? Mos është pak e tepruar që i ngarkojmë organet e qeverisjes vendore që çdo dy muaj të raportojnë? Mos do të ishte më mirë për t’i përcaktuar se kur ka burime të reja të zbuluara, të evidentuara e të tjera ato të raportohen menjëherë brenda një periudhe të caktuar tek ministria juaj?

Raporti me Ministrinë e Zhvillimit Urban, e lidh tani te kreu IV, me planifikimin e zhvillimit të turizmit. Në nenin 25 thuhet: “Përgatitja e planit kombëtar sektorial të turizmit”, shoh se jeni ju ministria përgjegjëse për përgatitjen e këtij plani. Ne kemi kaluar një ligj “Për planifikimin urban”, kemi Ministrinë për Zhvillimin Urban, do të doja raporte më të qarta të planeve tuaja të zhvillimit të turizmit që ligji ju jep juve dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban.

I kthehem nenit 30. Kemi një përplasje midis ligjit “Për prokurimin publik” dhe mbështetjes për projekte në fushat turistike. Jam dakord me ju. Ka nevojë për fleksibilitet për programet e nxitjes. Ju krijoni një komision për zgjedhjet e projekteve. Ky komision është *ad-hoc*, është komision i përhershëm?

Pyetja e dytë është e njëjtë si për nenin 11, kur kompozoni këtë komision për përzgjedhjen e projekteve dhe e bëni pa prokurim, a nuk ka rëndësi vlera e fondit vjetor që keni? Nëse vlera kap shifra të mëdha: një milion, dy milionë, a nuk ka nevojë të tenderohet?

E dyta, dy përfaqësuesit nga shoqatat e sektorit të turizmit, duke qenë pjesë e këtij komisioni, a kanë të drejtë të përfitojnë nga paketat promovuese edhe nga shërbimet? Përsëri e lidh me ligjin “Për konfliktin e interesave”.

E fundit, në nenin 34, i cili bën fjalë për vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, kohëzgjatja për një euro për 99 vjet, në çfarë raporti do të jetë? Thuhet që Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës miraton vënien në dispozicion. Po në raport me pronarët aktualë, i kthehem ligjit “Për sigurinë juridike”, ka pronarë aty, apo jo, do t’i shpronësojmë? Ju thoni pasuri të paluajtshme shtetërore, pasuria mund të jetë ndërtesa, po toka? Ajo mund të ketë pronarë, ish- pronarë, mund të kemi vendime të Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave. Me këtë nen i rikthehem shqetësimit që ngriti zoti Xhafaj, ne mund të prekim një sërë problemesh të tjera dhe vëmë në vështirësi shumë të mëdha problemin e zgjidhjes së pronësisë, për të cilën ne jemi ndëshkuar rëndë nga Gjykata e Strasburgut.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderti!

Po, zoti Ahmetaj!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Hysi, për pyetjet!

Po i referohem pyetjes suaj të parë për konfliktin e interesit, që është neni 11 në mos gabohem. Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit, pra jemi duke folur për një komitet këshillimor jo në varësi të ministrit të Turizmit, është një komitet këshillimor, i cili sjell operatorë dhe aktorë të ndryshëm për të dhënë mendime të detajuara, këshillon ministrinë për hartimin e strategjisë. Ai trajton çështje që kanë lidhje me veprimtarinë

turistike, siguron bashkëpunim ndërmjet sektorit privat dhe ministrisë. Pra, ky komitet nuk ka vendimmarrje. Ajo që garanton ky komitet është një platformë dialogu me sektorin privat dhe me aktorët, në mënyrë që pastaj vendimmarrja të jetë e mirëkonsultuar. Ky është një kusht që ju na e vendosni vazhdimisht, nëse kemi debatuar, kemi diskutuar me sektorin privat. Nuk ka konflikti të interesit, në definicionin juridik, pasi nuk janë vendimmarrës, por janë nga sektori privat. Është një lloj si Këshilli Ekonomik Kombëtar.

Për sa i përket AKT-së, jemi duke iu referuar të njëjtës agjenci, AKT-së dhe asgjë nuk ka ndryshuar, vetëm për herë të parë referohet në ligj. Këtu do t'ju lutesha, pasi është rënë dakord dhe shpresoj që edhe bashkë të biem dakord, të reflektojmë dhe Agjencinë e Bregdetit, e cila është në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe ka akte specifike të krijimit dhe të funksionimit. Ne do t'jua sjellim edhe formatimin, pastaj është në vullnetin dhe dëshirën tuaj, që ta përfshini në ligj. Nuk ndryshon asgjë, e liron, e emëron Kryeministri praktikisht me propozim të ministrit të Turizmit. Është agjenci që i nënshtrohet statusit të nëpunësit civil.

I gjithë ligji na ndihmon të bëjmë më shumë hotele sesa agjenci.

Për sa i përket pyetjes për nenin 18, unë besoj se është një qëndrim i drejtë nga ana juaj. Ia vlen ta shikojmë që të mos jetë një herë në dy muaj, por të jetë me një periodik më të zgjatur. Po të kishim një situatë që një herë në dy muaj ndryshonin burimet turistike dhe inventari do të ishte fantastike, por nuk e kemi. Do ta shikojmë gjatë diskutimit nen për nen.

Te neni 25, përgatitja e Planit Sektorial të Turizmit, i takon Ministrisë së Turizmit të bëjë strategjinë e turizmit apo edhe planin kombëtar të turizmit në përputhje, siç shkruhet edhe në nen me planifikimin e territorit. Nuk është se ministrat veprojnë *ad-hoc* apo të veçuar, por kur bëhen gjëra kaq të rëndësishme, siç janë strategjitë apo edhe formatet e zhvillimi të sektorit, ka bashkëpunim. Nuk besoj se ka përplasje dhe kundërthënie.

Për nenin 30 të falënderoj për mbështetjen. Kur ta diskutojmë nen për nen, jam i hapur për ta definuar. Ajo që thatë është me vlerë.

Për sa i përket nenit 34, për pasuritë e paluajtshme shtetërore, bëhet fjalë vetëm për ato shtetërore, është me garë. Shpronësimi do të bëhet vetëm në bazë të ligjit “Për shpronësimet”, të interesit publik, vetëm për sa u përket investimeve strategjike që kalojnë ato shifra që kemi definuar në projektligjin që sapo mbyllëm “Për investimet strategjike”. Nuk cenon absolutisht të drejtën juridike dhe të drejtën e pronës. Pra, nuk ndryshojmë, nuk cenojmë asgjë nga formati i deri tanishëm, përkundrazi atyre u referohemi, klauzolave në ligjet specifike.

Nuk e di nëse i mora pyetjet tuaja një e nga një.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime?

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Kam për të thënë vetëm dy fjalë në fund të këtij diskutimi të gjatë. Ligji ka përpara dy sfida: të japë një zhvillim dhe një hop të ri, të jashtëzakonshëm të turizmit për të ardhmen e tij.

Unë do të ndaloja te një pikë tjetër që ka një sfidë shumë të madhe për të disiplinuar atë pasuri turistike, e cila ndodhet në territor. Është një rast i rrallë ku unë nuk jam plotësisht dakord me zotin Xhafaj. Mendoj se në Shqipëri ka mjaft hotele, janë të standardeve të larmishme, të paqarta dhe të paunifikuara, qoftë në shërbimin që ofrojnë, por edhe në problematike të tjera. Në planin praktik duke menduar, sikur do ta kisha unë këtë përgjegjësi, do të thosha se të gjitha investimet e reja që do të vijnë, të jeni të bindur se kërkojnë një kohë fizike të caktuar. Do të japin një sinjal shumë të rëndësishëm dhe të fortë ekonomik, por për sa i takon asaj që quhet pasuri turistike e vërtetë, do të duhet një kohë që ajo të realizohet në territor. Më e mira prej tyre do të marrë një vit e gjysmë, dy vjet dhe më shumë sesa kaq. Ne kemi një turizëm që synojmë ta kemi më të zgjeruar në kohështrirjen e tij, që është një sfidë e madhe, themelore, ku ligji ka reflektime të mëdha për këtë punë. Kemi edhe një fluks turistësh, vizitorësh, ne nuk kënaqemi, kemi shumë të drejtë, sepse duam realitete akoma më impresionante, por edhe që të hyjnë e të dalin një milion vizitorë e turistë, të cilët marrin shërbime është një realitet shumë i rëndësishëm për Shqipërinë turistike që ne kemi sot. Këtyre njerëzve detyrimisht, falë këtij legjislacioni këtë mendje të re që kemi, sepse deri më sot me atë mendje që ishte më përpara që strukturat turistike ishin një ndër dhjetëra aktivitete të tjera, si të licencohesh një që shiste presh dhe qepë, ashtu ishte edhe një strukturë turistike, do të thotë se ishte një vizion jo vetëm i prapambetur, por që nuk të çonte gjëkund në realitetin aktual. Insistimi për të imponuar standarde dhe për t'ju futur kësaj pune, të jeni të bindur, miqtë e mi, që do të jetë sfida e parë madhore me të cilën do të përballet ligji. Shinat e një turizmi të ri madhor janë shina që janë hedhur bashkë me ligjin “Për investimet strategjike”. Unë jam i bindur, jam nga ata që bëj pjesë në këtë rast të optimistët, që do të ketë përgjigje të mëdha dhe të rëndësishme, por në territor të gjithë ne këtu si përdorues të këtyre shërbimeve, por edhe shumë e shumë të tjerë, kam informacion se ka interesim të jashtëzakonshëm që pa filluar ende sezoni turistik në zona të caktuara turistike të Shqipërisë, siç është Saranda në mënyrë të veçantë, por edhe diku tjetër, të gjithë këta kanë përballë, dhe e gjithë çështja reduktohet në një çështje: standarde, shërbime të krahasueshme dhe

mundësi që këto struktura të shiten, që të shiten duhet të jenë të krahaseshme, prandaj duhet patjetër të shikohet me optikën e një veprimi shumë të fortë, konkret në terren, duke ecur në mënyrë shumë të shpejtë me aktet nënligjore përkatëse. E gjithë ajo strukturë që është parashikuar këtu, e cila ka edhe strukturat rajonale të vetat, duhet të vihen në funksion të kësaj gjëje. Nëse flasim me fjalë të thjeshta, trajtimi i një investimi të madh strategjik nuk ka për të qenë kompetencë e tyre, por kalon në linjë të tjera sesi do të ecë, dhe sesi do të realizohet. Puna e tyre është terreni. Mbrojtja e klientit, e konsumatorit, e vizitorit, e turistit, vërinë emrin si të doni ju, ka këtë tutelë shtetërore dhe ligjore. Të gjitha elementet që janë në ligj të standardizimit, që kanë të bëjnë me problemet e edukimit turistik, të certifikimit të udhërrëfyesve turistikë janë shumë të rëndësishëm. Ka sharlatanë që shesin Shqipërinë ndryshe nga sa është ajo. Mund të bëjnë një dëm të pallogaritshëm në një kohë që këtu bëhet një politikë shumë pozitive. Çdo element duhet të vlerësohet. Turizmi është me multi komponentë. Njëri i harruar, njëri i neglizhuar, është çështje perceptimi, ndjeshmëri negative apo pozitive mund të na tërheqë në gjërat e mëdha, por nëse harrojmë këto të voglat, opinionin, bërja negative, na rrënon edhe në atë drejtim.

Duke përshëndetur ligjin, i cili i ka thënë të gjitha gjërat e duhura, për sa i takon të ardhmes, por edhe të sotmes, sepse mjaft elemente të certifikimit, të standardizimit nuk kanë ekzistuar, është një pozitivitet shumë i lartë, që i vendos në këto shina, pra duke i thënë të gjitha këto, këmbëngulja dhe plotësimi me akte nënligjore, që do të jenë një mundim i madh, pasi shumë elemente duhet të jenë të standardizuara me standardet europiane, nuk mund të jenë të inventuara si shqiptare, sepse turizmi, duam apo nuk duam ne është i ndërkombëtarizuar. Më në fund futet në një hulli të një turizmi, i cili mëton të jetë një shërbim strategjikisht që krijon të ardhura të jashtëzakonshme për vendin, për Shqipërinë gjithmonë e më të hapur ndaj asaj bote, e cila edhe për shkak të disa pushimeve shumë të mira, mund ta shikojnë edhe si një mundësi për zhvillim, për investime të mëdha të karakterit ekonomik.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Vasili!

Në parim, nuk ka më diskutime. Bashkohem me kolegët, si edhe me vlerësimin që ata bënë, se ky është një ligj i një rëndësie të veçantë, që lidhet edhe me fushën, të cilën ka për objekt, edhe me interesat e veçanta të shoqërisë dhe të shtetit në këtë fushë, por edhe me faktin se kemi të bëjmë me një ligj kuadër, që do të rregullojë një fushë shumë të rëndësishme, e cila sot për hir të së vërtetës duhet thënë se është kaotike për shkak se mënyra, tradita, por edhe qasja që është operuar vit pas viti në këtë fushë nuk kanë mundësuar një

proces shumë më të strukturuar, shumë më të organizuar ashtu siç kërkohet për të zhvilluar këtë degë të rëndësishme të ekonomisë.

Jam dakord me kolegët që në nene të veçanta të projektit ka gjëra që janë të diskutueshme në vlerësimin tim, ashtu siç vazhdoj të mendoj përsëri se jam kundër strukturave të shumta që krijohen, prandaj bëra edhe krahasimin me hotelet, për të thënë, sidomos në fushën e turizmit, në vlerësimin tim personal, ka shumë struktura, agjenci e të tjera që dublojnë njëra-tjetrën, por mbetet në çmimin e qeverisë, por edhe tonin si ligjvënës, kur ta shqyrtojmë nen për nen, për të parë sesa mund t'i përputhim për të bërë struktura shumë më eficiente, që të jenë shumë përgjegjëse për ta menaxhuar me efektivitet këtë proces.

Ka edhe disa aspekte që lidhen me raportet, efektet që krijon ky projektligj me disa ligje kuadër, por mendoj se do t'i shikojmë ato nen për nen.

Këshilltarët e komisionit janë të lutur që gjatë këtyre dy ditëve të kenë mundësi të punojnë së bashku me relatorin për të parë se ku janë problemet, t'i shikojnë me ekspertët e ministrisë për të rakorduar në mënyrë që gjatë shqyrtimit nen për nen të jemi më eficientë në diskutimin e këtyre dy projektligjeve të rëndësishme, i atij që shqyrtoam në pikën e parë “Për investimet strategjike” dhe ligjin “Për turizmin”, një ligj i cili për hir të së vërtetës ka pritshmëri të shumta nga shumë operatorë të tregut, por edhe nga ne vetës si qytetarë.

Faleminderit, zoti Ministër!

Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë.

Falënderoj kolegët dhe të gjithë ata që patën durim për të na ndjekur deri në fund.

Mbyllet mbledhja.

MBLEDHJA MBYLLET